



Duke u bazuar në nenin 43, 45 dhe 47 të Ligjit për Vetëqeverisje lokale, Nr.03/L-040, nenin 47 të Statutit të Komunës së Klinës Nr. 01-110-1232/2010. Nenin 5 të Udhëzimit Administrativ MAPL Nr.02-2015 për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendit të komunës si dhe nenit 4 të Rregullores për Punë të Kuvendit dhe Komiteteve të Komunës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës bën këtë:

F T E S Ë

Ftohën të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës së Klinës dhe të interesuarit e tjerë që të marrin pjesë në seancën e **III-të të rregullt të punës së kuvendit për vitin 2024.**

Seanca mbahet më **29.03.2024 (e Premte)**, në sallën e Kuvendit të Komunës së Klinës dhe fillon në orën **10:00.**

Lidhur me çështjen e mospjesëmarrjes në seancë, t'i referoheni dispozitës së nenit 39 të LVL-së. Për këtë seancë propozohet ky:

RENDI I DITËS:

1. Arsytimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimeve të Komitetit për Politik dhe Financa,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit të DKA-së për ndërrimin e titullarit të pronës për parcelën me nr.P-71006024-00422-2 (ref. nga DKA),
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit të DKRS-së për ndarje të mjeteve për mbajtjen e festivalit folklorik "I Këndojmë Lirisë" (ref.nga DKRS),
6. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës për ekipin komunal për të drejtat e fëmijës 2024-2026 (ref.nga grupi punues),
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për vënie në diskutim publik rregulloren për taksa, tarifa dhe ngarkesa komunale (ref.drejt.fin),
8. Informatë mbi menaxhimin e situatave në mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit dimërorë (ref. DSHPE),
9. Themelimi i komisioneve sipas kërkesës së këshilltarëve nga radhët e LVV-së (ref. këshilltaret e LVV),
10. Pyetje dhe përgjigjeje.

01Nr. 06-8252 2024
Klinë, me 18.03 2024



Kryesuesi,
Fadil Gashi



Na osnovu člana 43, 45. i 47. Zakona o lokalnoj samoupravi, br. 03/L-040, člana 47. Statuta opštine Klina br. 01-110-1232/2010. Članom 5 Administrativnog uputstva MAPL br. 02-2015 za održavanje sednica skupštine opštine kao i člana 4 Pravilnika o radu Skupštine i opštinskih komisija, Predsedavajući Skupštine opštine vrsi:

OBAVESTENJE

Pozivaju se su svi odbornici Skupštine opštine Klina i ostali zainteresovani da učestvuju na III redovnoj radnoj sednici Skupštine za 2024. godinu..
Sednica se održava 29.03.2024 (petak), u sali Skupštine opštine Klina sa početkom u 10 časova.
U vezi sa pitanjem neučešća na sednici, pozvati se na odredbu člana 39. ZLS.
Predloženiz:

DNEVNI RED:

1. Obrazloženje izostanaka,
2. Razmatranje i usvajanje zapisnika sa prethodnog sastanka,
3. Razmatranje i usvajanje preporuka Političkog i Finansijskog odbora,
4. Razmatranje i usvajanje predloga-odluke DKA za promenu vlasnika nepokretnosti za parcelu broj P-71006024-00422-2 (ref. DKA),
5. Razmatranje i davanje saglasnosti na predlog-odluke DKRS za dodelu sredstava za održavanje Smotre folkloru „Pevamo Slobodi“ (ref. iz DKRS),
6. Razmatranje i usvajanje plana rada opštinskog tima za prava deteta 2024-2026 (ref. od radne grupe),
7. Razmatranje i davanje saglasnosti na predlog-odluke za stavljanje u javnu raspravu uredbe o porezima, taksama i komunalnim naknadama (ref. direkt.fin),
8. Informacije o upravljanju situacijama u održavanju puteva i trotoara tokom zimske sezone (ref. DSHPE),
9. Formiranje komisija na zahtev savetnika iz redova LVV (ref. LVV savetnici),
10. Pitanja i odgovori.

01Br. 06-8252 2024
Klina, 18.03 2024



Predsedavajući,
Fadil Gashi



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

DREJTORIA E ARSIMIT

01 Nr. 463-6103 2024

Datë 28.02 2024

Për: z. Fadil Gashi, Kryesuesin e Kuvendit

Nga: Drejtori i DKA-së Dr.sc. Qemajl Sejdijs



Lënda: Kërkesë ndërrimin e pronarit për parcelën nr.442-2

Kërkojmë nga Kryesuesi i Kuvendi Komunal z. Fadil Gashi që për seancën e **muajit mars 2024** të na mundësoj futjen ne rend dite, në piken "Të ndryshme", propozimin për lejimin e ndryshimit të pronarit për parcelën kadastrale parcelës **nr. P-71006024-00422-2** e cila parcelë sipas vendimit të Kuvendit Komunal Komuna e Klinës **01 nr. 610-41145/22 te datës 07.12.2022** kishte bërë ndarjen fizike te parcelës **nr. P-71006024-00422-0** ku nga kjo parcelë kishte ndarë 30 ari për ndërtimin e çerdhes se re e cila pritet te ndërtohet ne oborr të SHFMU "Motrat Qiriaz" në Klinë, por me rastin e ndarjes se parcelës dhe krijimit te fletës poseduese për parcelën nr. **nr. P-71006024-00422-2** shihet që ekzistojnë të dhënat për poseduesin me emrin **PRONË SHOQËRORE-SHK. ILL.V.KARAXHIQ**, andaj kërkojmë që kjo pronë të kalohet ne pronësi komunale dhe të figuron emri i poseduesit Komuna e Klinës.

Faleminderit për ndihmesën dhe bashkëpunimin tuaj.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71006024-00422-2

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	11-97-24
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	15.01.2024 - 15:11
Komuna / Opština / Municipality:	KLINË / KLINA / KLINË
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	Klinë / Klina / Klinë
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	KLINË / KLINA / KLINË

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësisë Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-71006024-00422-2	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land	Urban	3000	Sipas Vendimit 01 nr.06-41145/22 prej 07.12.2022 Kuvendi Komunal Klinë- regjistri i fletpunëqitjeve nr.5/2023.	08.02.2023	

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKJE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
BUKE-			08.02.2023	

Asllan Pantina

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m²) Površina (m²) Area (m²)
2	Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture	Livadhë/Livade/meadow	Livadh I Klasës 3/Livada 3 Klase/3rd Class Meadow	3000

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Lleni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojedinsti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posëdim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	PRONË SHOQËRORE- SHK.FILL.V.KARAXHIQ	KCID1001238	KLINË / KLINA / KLINË			1/1	20-1996	08.02.2023



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY


KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : KLINË

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Klinë

Kr. 11/97-24 - Regjistrimi

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-71006024-00422-2	Parcelë / Parcela / Parcel	3000



Shkalla/Razmera/Scale: 1:2500

Punoi/Obradio/Created: Altin Mujaj

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Data/ Data/Date: 15.01.2024

Koha/ Vreme/ Time: 03:20:13



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Duke u mbështetur ne nenin 17, në shkronjën c), d) dhe s) nenit 40 paragrafi 40.2 nën pikën l) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040, Planin Zhvillimor Komunal si dhe duke u bazuar në Hartën Zonale të Komunës së Klinës të miratuara në vitin 2020. Nenit 40 paragrafi 40.2 nën pikën 11 të Statutit të Komunës së Klinës, me kërkesën 01Nr.463-36653 të datës 25.10.2022 të parashtruar nga drejtoria e Arsimit, me Rekomandimin e Komitetit për Politik dhe Financa të datës 14.11.2022, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e X-të rregullt për vitin 2022, të mbajtur me datën 02.12.2022, mori këtë:

VENDIM

Për

ndarjen e parcelës në sipërfaqe prej 3000m² nga parcela me Nr. P-71006024-00422-0 ZK Klinë

1. Miratohet kërkesa e parashtruar nga DKA për ndarje të parcelës me Nr. P-71006024-00422-0 ZK Klinë e cila do të shërbej për ndërtimin e çerdhes.
2. Nga parcela me Nr. P-71006024-00422-0 e cila ka një sipërfaqe prej 10576 m² do të ndahen 3000m² për ndërtimin e çerdhes.
3. Kompetent për ekzekutimin e këtij vendimi është Kryetari i Komunës në koordinim me drejtorin e Kadastrës, Gjeodezisë dhe Pronësisë dhe Drejtorin e Arsimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, sipas rregullores (QRK) Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në ueb faqen e Komunës.
5. Me këtë vendim njoftohet: MAPL, Kryetari i Komunës, Drejtoria e Kadastrës, Gjeodezisë dhe Pronësisë Drejtoria e Arsimit, Zyra e Informimit dhe Arkivi i Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr. 06-41145 2022
Klinë, me 02.12.2022



Kryesuesi,
Fadil GASHI



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

www.komuna-kline.org

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA




Për:	Kuvendin Komunal, Kryesuesin e kuvendit z.Fadil Gashi
Nga:	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Klinë, Drejtoresha: Fatjona Gashi 
Lënda:	Kërkesë
Datë:	27.02.2024
Vendi:	Klinë



I nderuar kryesues z. Fadil Gashi

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit kërkon nga ju që në seancën e rregullt të Kuvendit Komunal në muajin mars, të vendoset pikë diskutimi dhe në votim ndarja e mjeteve buxhetore nga kategoria e subvencioneve në DKRS, për festivalin "I Këndojmë Lirisë" në vlerë prej 25.000€.

Me respekt!



Për: z.Fadil Gashi, kryesues i Kuvendit Komunal, Klinë

08, 03, 2024

Nga: Këshilltarët Komunal nga radhët e Lëvizjes VETËVENDOSJE!-Klinë

KËRKESË

K. ...	Organi ...
01-06-7161/24	

Me anë të kësaj kërkesë, ne anëtarët e Kuvendit Komunal nga radhët e Lëvizjes VETËVENDOSJE!, ju drejtohem juve, z. Gashi, si autoritet me pozitën e kryesuesit të Asamblesë Komunale, në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe të drejtën ligjore për propozime të anëtarëve të Asamblesë. Kërkojmë që në mbledhjen e radhës të muajit Mars të vendosen në rend dite kërkesat tona:

1. Formimin e një komisioni hetimor nga Asamblesja komunale me anëtarë të të gjitha partive politike për verifikimin e punësimeve në Komunë, sidomos me kontrata mbi vepër.
2. Formimin e një komisioni komunal për sqarimin e numrit të lejeve apo pelqimeve të operatorëve gurthysve që ekzekutivi i komunës i ka dhënë për këto gurthyse që po e dëmtojnë ambientin.

Këshilltarët Komunal:

Prof. ass. dr.sc.Zafer Gashi

Valmire Krasniqi



- PËR:** Komitetin për Politike dhe Financa, Kryesuesin **z. Fadil Gashi**;
Shërbimin për Punë të Kuvendit udhëheqësin **z. Ahmet Berisha**;
- NGA:** Kryetari i Komunës së Klinës **z. Zenun Elezaj**; 
- LENDË:** Kërkesë për futje në rend të ditës të KPF-së ne seancën e marsit 2024, Draft Planin e Punës së Ekipit Komunal për të Drejtat e Fëmijës 2024-2026.



Te nderuar,

Meqenëse nga ekipa përgjegjëse është përgatitur Draft Planin e Punës së Ekipit Komunal për të Drejtat e Fëmijës 2024-2026, kërkojmë nga ana juaj që të futet në rend të ditës së KPF-së për seancën e marsit 2024, shqyrtimi i këtij dokumenti si dhe t'i preferohet Kuvendit të Komunës së Klinës që për seancën e radhës i njëjti të miratohet.

Shtojcë: Bashkëngjitur këtij dokumenti gjani Draft Planin e Punës së Ekipit Komunal për të Drejtat e Fëmijës 2024-2026.

Me respekt,

01Nr. 060-6017/2024
Klinë, datë 22/07/2024



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

PËR/ZA/TO:	z. Fadil Gashi - Kryesues i Kuvendit Komunal të Klinës
NGA/OD/FROM:	z. Enver Berisha, Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim
TEMA-ÇËSHTJA	DRAFT-RREGULLORE PËR TAKSA, TARIFA DHE NGARKESA KOMUNALE 08.03.2024
DATË:	08.03.2024

I nderuar kryesues i Kuvendit Komunal,

Orga
01-06-7142/24

Me anë të kësaj shkrese kërkojmë nga ju si Kryesuesi i Kuvendit, që të fut në rend ditës për mbledhjen e radhës të Komitetit për Politik dhe Financa, propozimin si pikë të rendit të ditës për vënien në diskutim Publik të Draft Rregullorës për Taksa, Tarifa dhe Ngarkesa Komunale e me pastaj të përcjellët edhe në seancën e rregullt të punës së Kuvendit.

Drejtori:
Enver Berisha





Kuvendi i Komunës Klinë

01Nr. _____ 2024

Klinë,

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e punës së Kuvendit të Komunës të mbajtur me datë 23 Shkurt 2024 në ora 10:00 në Sallën e Kuvendit të Komunës.

Pjesëmarrës në mbledhje është kryetari i Komunës, z. Zenun Elezaj, përfaqësuesi i policisë, drejtorë të drejtorive, media lokale dhe qytetarë.

Mbledhjen e hapi kryesuesi i Kuvendit, z. Fadil Gashi i cili para se te futej në rendin e ditës kërkoj nga anëtarët e kuvendit që ta informojnë edhe një herë dakordimin për vizitën e punës në Kroaci në maj të këtij viti pasi që ekzekutivi duhet të nisë procedurat. Konfirmuan të gjithë pjesëmarrjen. Për Rendin e Ditës, kryesuesi hapi debat.

z. Esat Raci: Përshëndetje për të gjithë. Një kërkesë më është dërguar mua dhe besoj të gjithëve, nga PJQ “Zana”. Një ankesë/ A do ta shqyrtojmë në këtë seancë apo në seancën e radhës.

z. Arben Limanaj: Përshëndetje të gjithëve. Edhe ne si grup e kemi marr këtë ankesë nga OJQ “Zana” për mos dorëzim të dokumentacionit nga komisioni komunal për dëmet e krijuara nga vërshimet dhe jemi dakord që ta shqyrtojmë sot.

z. Valmir Bacaj: Përshëndetje të gjithëve. Mendoj që për atë lëndë është përgjegjësi e komisionit dhe një deklaram i komisionit do të ishte i mirëseardhur.

z. Fadil Gashi, kryesues: Po kërkoj që tek pyetje dhe përgjigje do ta sqarojmë këtë kërkesë nga drejtori përkatës.

Me 2 vota kundër, asnjë abstenim dhe me 24 vota pro U MIRATUA.

Pika e 1 e Rendit të Ditës: Arsyetimi i mungesave

Kryesuesi Konfirmoj që znj, Mende hije Duraku ka lajmëruar paraprakisht që nuk merr pjesë.

Pika 2 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

z. Zafer Gashi: Përsëritet për të pranishmit. Nuk është përpiluar ashtu siç duhet ky proces, mendoj që disa gjera që kanë qenë nuk janë shkruar. Herën e kaluar...(Ndërhynë kryesuesi i kuvendit duke kërkuar që të koncentrohet rreth procesit por z. Gashi nis një debat interaktiv me kryesuesin për atë që kanë debatuar në seancën e kaluar. Dialogu interaktiv zhvillohet herë me mikrofon të ndezur dhe herë të fikur prandaj është e pamundur që të shkruhet.)

Në lidhje me ngjarjen e zhvilluar në mbledhjen e kaluar foli edhe z. Esat Raci dhe kërkoj që mos marrëveshjet të tejkalohen me gjakftohtësi. Por ai tha se askush mos të mendoj që mbrohet pas pushtetit dhe për ne si asamblist çdo gjuhë fyese është e dënueshme.

Kryesuesi tha gjithashtu se është mirë të ruhen raportet e mira në kuvend dhe të jemi të arsyeshëm sepse ne do të vazhdojmë të jetojmë e të takohemi edhe pas këtij mandati bashkë. Sjelljet tona duhet të i kontrollojmë dhe nuk mund të ja marr fjalën kolegu-kolegut. Procesverbali shkruhet vetëm ajo pjesë kur mikrofonin është i ndezur.

z. Arben Limanaj: Në lidhje me seancën e muajit të kaluar në emër të grupit kuvendar kërkoj një komunikim më të mirë nga ekzekutivi me neve si asamblistë sepse një gjuhë e tillë komunikuese nuk është dëgjuar asnjëherë prej pas luftës. Gjuhë e tillë e komunikimit kërkoj që mos të përsëritet më.

Me 24 vota për , dy vota kundër U MIRATUA procesverbali.

Mbledhjen e kuvendit e braktisin dy anëtarët e LVV-së, z. Zafer Gashi dhe znj. Valmira Krasniqi

Pika 3 e Rendit të Ditës: Rekomandimet e KPF-së

Me 24 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim u miratua rekomandimi i parë i KPF-së

Kërkesa e dytë për sigurimin e një banimi social i znj. Mirjeta Hisenaj që jeton e vetme me një fëmijë pa të ardhura u rekomandua në zyrën e kryetarit dhe në drejtorinë e Urbanizmit, në programin tre vjeçar për banim.

Me 24 vota për u MIRATUA edhe kërkesa e dytë e rekomanduar.

Kërkesa tjetër e znj. Nazife Gucati për të siguruar një banim, KPF e ka trajtuar njëjtë sikurse kërkesën paraprake dhe me 24 vota për U MIRATUA

Kërkesa e 4 me radhë e parashtruar nga prof. dr. Lush Culaj , kërkesë që Ymer Berisha të dekorohet me çmimin “Nderi i Klinës”.

Kjo kërkesë sikurse të gjitha të tjerat tha kryesuesi se është shqyrtuar në KPF dhe është e nevojshme formimi i një komisioni. Ai shpjegoi se cilat do të jenë detyrat e atij komisioni duke u bazuar në rregulloren komunale për ndarjen e titujve, çmimeve etj. Pasi ta ketë kryer punën komisioni në një seancë të radhës e sjell në kuvend për miratim.

z. Valmir Bacaj: Ne pajtohemi që të vazhdojmë tutje me formimin e komisionit ashtu siç e parasheh rregullorja.

Kryesuesi kërkoj që të bëhen propozimet për komisionin.

U propozuan : z. Kolë Prenaj, znj. Lirije Gashi, znj. Besiana Gashi, znj. Blerina Gashi

Znj. Lirie Gashi: Përshëndetje të gjithëve. E falënderoj z. Bacaj për propozimin por dëshiroj që të respektoj dike tjetër pasi që jam në shumë komisione.

z. Valmir Bacaj: Atëherë e propozojmë Ilirjana Toplanaj.

Dy propozime mbetet të plotësohen nga kryetari i komunë s dhe një nga shoqëria civile.

Me 21 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA komisioni i propozuar.

Kërkesa e fundit e rekomanduar nga KPF është ajo e Komitetit për komunitete , kryesuesja e këtij komiteti për pagesën e anëtarëve të komitetit në fjalë.

Kryesuesi tha se probleme të tilla ka me shumë komitete të tjera dhe që ky problem derivon nga ligji i ri i pagave. Është absurd i llojit të vet që brenda një komiteti 3 anëtarë paguhet e katër anëtarë nuk paguhet, tha kryesuesi. “ Nuk kemi lenë institucion por edhe në kuadër të kolegjiut të kryetarëve që nuk e kemi diskutuar dhe kërkuar zgjidhje por deri tani nuk kemi gjetur. Janë dokumentet që i ka prodhuar ministria, udhëzimin administrativ për themelimin e komiteteve dhe kompensimin e pjesëmarrjes së anëtarëve në këto komitete. Baza që ne kemi janë këto dy dokumente dhe të marrim një vendim formal dhe të presim ligjshmërinë e tij” tha kryesuesi i Kuvendit z. Fadil Gashi

z. Valmir Bacaj: Ne jemi pro votimit të një vendimi formal dhe të presim ligjshmërinë e tij.

z. Esat Raci: Edhe ne jemi që të votohet pro por kërkoj nga drejtoria e financave që bashkë me ministrinë e financave të gjejë mënyrën e kompensimit të anëtarëve të këtyre komiteteve.

z. Arben Limanaj: Edhe ne jemi pro që të gjendet mënyra e pagesës së komiteteve, disa komuna po aknë mundësi që të paguhet , të shikohet se si po arrijnë ato komuna të bëjnë pagesat ndaj anëtarëve të këtyre komiteteve.

Znj. Besiana Gashi: Edhe unë bashkndaj të njëjtin mendim më juve që të gjendet një zgjidhje. Ju falënderoj juve kryesues për bashkëpunimin që kemi pasur deri me tani. Kërkesat e mia deri të arrihet zgjidhja e këtij problemi s`ka me u ndalë edhe nëse ky vendim që do të marrim sot nuk do të kaloj ligjshmërinë e tij.

Znj. Lirie Gashi: Edhe unë e kam këtë kërkesë që komitetet dhe komisionet e themeluara në këtë kuvend të paguhet para se ato të dështojnë për mos pagesë.

z. Fadil Gashi, kryesues: Qëllimi ynë është që të gjejmë një zgjidhje që ka bazë e mos ta fusim në “penallti” as veten as ekzekutivin.

Me 20 vota për , asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA vendimi për kompensimin e komiteteve dhe trupave që i formon kuvendi.

Pika 4 e Rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për bartjen e mjeteve nga viti 2023

z. Enver Berisha, drejtor i FEZH: Përshëndetje të gjithëve. Janë shuma e mjeteve të mbetura nga viti 2023 të bartura në vitin 2024 e që janë në vlerën prej 942 mijë e 121 euro. Ju e keni parë edhe në dokumentin që jua kemi dërguar se si janë bërë shpërndarjet e këtyre mjeteve nëpër programe e kategori.

Drejtori z. Berisha tha në fund se ka një sqarim për procesverbal tek kategoritë e shpenzimeve komunale dhe tek administrata e arsimit- renovimi i gjimnazit: thuhet rindërtim por është renovim, termi Rindërtim na është obliguar nga niveli qendror. Tjetër është arsyetimi për bartjen e obligimeve të pashlyera të nxehjeve qendrore me pompat termike dhe rritja e tarifave për shpenzimet e pastrimit. Është fjala për mirëmbajtjen e ambientit të jashtëm.

z. Esat Raci: A ka mundësi që në subvencione të rritet buxheti. Pasi që ka kërkesa si kjo e Samije Gjergjit dhe ajo e OVL

z. Enver Berisha, drejtor i FEZH: Është planifikimi vjetor i subvencioneve. Unë mendoj që janë të mjaftueshme këto mjete.

z. Valmir Bacaj: Ne si grup kuvendar i AAK pajtohem me bartjen dhe shpërndarjen e këtyre mjeteve dhe mendojmë që janë në mënyrë të arsyeshme të shpërndara.

Me 19 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA.

Pika 5 e Rendit të ditës: Shqyrtimi procesverbalit nga mbledhja e dytë e kryetarit të Komunës me qytetarët e Komunës së Klinës.

Pika 6 e Rendit të Ditës: Pyetje dhe Përgjigje

Kryesuesi tha se te kjo pikë mbi një minutë nuk i lejohet askujt më shumë.

Fillimisht fjalën e merr drejtori i shërbimeve publike dhe emergjente për tu përgjigjur në ankesën e OJQ “Zana” që u diskutua në fillim të seancës.

z. Qendrim Millaku, drejtor i SHPE: Përshëndetje të gjithëve. Sa i përket ankesës së OJQ “Zana” për mos dorëzimin e dokumentacionit mbi dëmet e krijuara nga vërshimet në komisionin qendror , komisioni komunal në afatin 15 ditor ja ka dorëzuar raportin komisionit qeveritar. Ka respektuar në maksimum afatin dhe ka dhënë informata dhe shpjegime shtesë gjithsesi. Të gjitha obligimet e tjera pas kësaj janë të komisionit qeveritar. Citoj shkresën e OJQ “Zana” , me datë 1.02. 2024, sipas OJQ “Zana” lista nuk ka shkuar në komisionin qeveritar sepse po në atë datë ky komision ja paskan dërguar komisionit komunal një email për plotësim të dokumentacionit për biznese. Si ka mundur ta dërgoj email ky komision qeveritar tek ne për plotësim dokumentacioni nëse ne nuk jua kemi dërguar raportin

paraprakisht? Ne çdo gjë e kemi dërguar me kohë tek komisioni qendror por ata nuk e kanë dërguar ende në ministrinë e financave pasi që akoma nuk janë bërë ekzekutimet e pagesave. E vërtetë që aknë kërkuar sqarime shtesë dhe ne jua kemi dërguar , mendoj që shumë shpejt pritet të bëhen pagesat që nuk janë bërë akoma në disa raste.

z. Esat Raci: Faleminderit Qendrim. A ka komisioni dëshmi që raporti është dërguar në komisionin qendror?

z. Qendrim Millaku, drejtor i SHPE: I kemi të gjitha dëshmitë , janë emaillet, shkresat etj. Këtë mund të jua dokumentoj me dokumente zyrtare në seancën ardhshme.

z. Arben Limanaj: OJQ “Zana“ i ka evidentuar dy data ku thuhet se ministria nuk ka marrë dokumentacion nga komisioni për vlerësimin e dëmeve. Pyetja e ime është a do të kompensohet OJQ “Zana” për dëmet e shkaktuara.

z. Qendrim Millaku, drejtor i SHPE: Raporti i komisionit komunal është dërguar tek komisioni qendror, tani kur ai komision e dërgon në ministri i financave me siguri që do të bëhen pagesat.

z. Zenun Elezaj, kryetar i komunës: Raporti i Komisionit Komunal për dëme është aprovuar në kuvend , ky raport i shkon komisionit qeveritar dhe komunikimin me ministrinë e financave nuk e bënë komuna por AME. Edhe për vlerat e dëmeve edhe gjithçka tjetër është në raport i cili është edhe në web të Komunës.

Z. Esat Raci: Pyetje për drejtorin e Bujqësisë. Para disa ditëve keni bërë ndarjen e disa traktorëve të vegjël. Kush ka qenë në atë komision për ndarjen, cilat kritere kanë qenë për ndarje , ai komision a ka dalë në teren dhe ky komision për ata qytetarë të pakënaqur a jua ka dhënë të drejtën për ankesa dhe a janë shqyrtuar ato ankesa. Kam vërejtje nga qytetarët se ato ankesa nuk janë shqyrtuar,

z. Lorenc Marleku, drejtori i Bujqësisë: Përhëndetje. Ata traktor të vegjël kanë qenë donacion, edhe kriteret edhe komisioni për vlerësim ka qenë i përbërë nga donatori. Po kanë dalë në teren por ndoshta nuk e kanë kontaktuar personin që ka aplikuar. Nuk besoj që ka pasur ndonjë shkelje por kur bëhen 177 kërkesa dhe ke me jua nda vetëm 60 vetave normal që ka me pas të pa kënaqur. Tani do të kemi edhe dy procedura të tjera për vitin 2024 dhe besoj që do të marrin të gjithë ata që do të aplikojnë. Ka pas shumë aplikues në kushte të barabarta.

z. Esat Raci: Me gjithë respektin për punën tuaj nuk jam aspak i kangur me atë që u përgjigje. Sipas qytetarëve në më shumë se 80% të aplikuarve nuk ka qenë komisioni fare që të i vizitoj po ashtu ankesat nuk janë shqyrtuar fare por janë bërë ndarjet pa i shqyrtuar ankesat.

z. Lorenc Marleku, drejtor i Bujqësisë: Kur vjen lista nga komisioni ne do ta aprovojme sepse unë nuk jam komision. Ne do të kemi kujdes që këta që kanë aplikuar të përfitojnë në radhën tjetër. Unë jam që të shtohet buxheti në bujqësi sepse jemi vend agrar. Ju si opozitë

nuk keni ngrit asnjëherë kërkesë që të rritet buxheti në bujqësi, është dashtë të bëni opozitarizëm të duhur.

z. Esat Raci: Derisa përcaktohen kriteret dhe nuk shkohet sipas kriterëve , derisa aplikuesit ankohen dhe ju nuk i shqyrtoni ankesat e tyre ju keni bërë shkelje ligjore. Sa i përket opozitarizimit ne e kemi votuar buxhetin për hir të qytetarëve ashtu siç ju e keni paraparë.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Mbetët që drejtori i bujqësisë të na jep informatë në seancën e radhes se a janë kthyer përgjigjet ankuesve.

Znj. Besiana Gashi: Kam një pyetje për drejtorin e shërbimeve publike: Pse në fshatin Çabiq nuk është shpërnda ndriçimi nëpër të gjitha lagjet pasi që ka ankesa nga qytetarët e atyre pjesëve se është bërë ky dallim. Kërkoj gjithashtu nga ekzekutivi që më shumë të realizojnë projekte cilësore e jo sasiore. Po ashtu kam dëshirë që të i them drejtorit të bujqësisë se aspak nuk jam e kënaqur me punën dhe mënyrën se si është realizuar projekti i theksuar rreth multikultivatorëve. Nuk bëhet vlerësim i drejt nëse pyeten të tjerët për fermerin, duhet bërë takimi direkt me fermerin.

z. Qendrim Millaku, drejtor i SHPE: Çabiqi është një nga fshatrat që është pajisur 99% me ndriçim. Kur një pjesë e atij instalimi nuk punon atëherë është problem i KEDS. Sidoqoftë Çabiqi është fshati që 99% është i mbuluar me ndriçim dhe kjo duke ju falënderuar kryetarit të Komunës.

z. Lorenc Marleku, drejtor i Bujqësisë: Ju e dini që ne një kohë të gjatë japim subvencione. Nëse shkon në shtëpi dhe e pyet fermerin se a ka traktor apo a ka marr vitin e kaluar, ai do të thotë jo. Ne duhet të gjejmë formën se si me e vërtetu. Kriteret janë shqyrtuar në mënyrën më të mirë. Ka pas shumë që i kanë plotësuar kriteret dhe kanë qenë në kushte të barabarta por s'kanë pas mundësi që të marrin . Në fazat e tjera do të marrin gjithsesi.

z. Enver Gashi: Problemi i geneve endacak vazhdon të jetë aktual, A keni ndonjë projekt për zgjidhjen e këtij problemi?

z. Qendrim Millaku, drejtor i SHPE: Ne e kemi buxhetin që e kemi e si rrjedhojë edhe mundësinë e kufizuar. Komuna nuk ka kapacitet me buxhetin që ka prandaj kemi kërkuar edhe nga ministria ndihmë financiare. Me mundësitë që kemi po e bëjmë kastrimin dhe trajtimin e tyre.

Znj. Blerina Gashi: Kam një pyetje për drejtorin e shëndetësisë i cili nuk është prezent. A ka mundësi të na informoj për disa vaksina që janë duke u dhënë për vajza të mitura në lidhje me kancerin e qafës së mitrës. Unë mendoj që sado që kanë efekt të mirë ato vaksina është mirë që paraprakisht të informohen prindërit. Kam edhe një kërkesë për drejtorin e inspektoratit në lidhje me një shqetësim të banorëve të Qupevës së lartë. Lutem që të gjeni një zgjidhje ose të vendosni ndonjë pengesë sepse nëpër rrugën e fshatit po kalojnë makineri me shpejtësi të lartë.

Z. Faruk Smajli, drejtor i inspektoratit: Mora shënim rrugën që e përmendët. Nëse kërkohet policë të shtrirë do ta shqyrtojmë mundësinë e për të tjerat do të informohen organet përkatëse.

z. Tunë Dedaj: Përshëndetje. Dua ta falënderoj kryetarin e Komunës për rritjen e buxhetit për bujqësi. Kam një kërkesë për drejtorin e bujqësisë që të mos kaloj afati i mbjelljes para se me ju ndarë ata multikultivator fermerëve. Kërkesë e imja tjetër është që të keni vëmendje e mos të ju epet multikultivatori atyre që nuk e punojnë token as atyre që e shesin.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Ka fenomene që një multikultivator e ka marr burri, një tjetër gruaja etj., Në këto raste komisioni nuk ka nevojë të shkoj në shtëpi të fermerit sepse e ka listën që ata kanë përfituar herë e kaluar. Subvencionet këtë vit janë të rritura , janë 600 mijë euro dhe do ta menaxhojmë shumë mirë këtë vlera duke jua mundësuar fermerëve që të marrin këto mekanizma dhe të punojnë në të mirë të familjeve të tyre.

Fjala e kryetarit të Komunës ishte e fundit në këtë mbledhje të kuvendit. Kryesuesi z. Gashi duke falënderuar të gjithë për kontributin e dhënë dhe pjesëmarrje i shpalli të mbyllura punimet e kësaj seance.

Procesmbajtës:

Skënder Behramaj

Kryesues:

Fadil Gashi



Kuvendi i Komunës Klinë

Komiteti për Politikë dhe Financa

01Nr 06-8412 /24

Klinë: 19.03 /2024

PËR: Kuvendin e Komunës Klinë

Nga: Komiteti për Politikë dhe Financa

Kryesuesi i Komitetit: Fadil Gashi



REKOMANDIMET e Komitetit për Politikë dhe Financa, të datës: 08.03.2024

Komiteti për Politikë dhe Financa, në mbledhjen e III-të për vitin 2024, përveç pikave të parapara në rend dite, shqyrtoi dhe miratoi për shqyrtim dhe miratim në Kuvend këto pika:

-Propozim-vendimin e Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, për vënie në diskutim publik draft-rregulloren për taksa, tarifa dhe ngarkesa të tjera komunale.

-Propozim-vendimin e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, për ndarje të mjeteve financiare për organizimin dhe mbajtjen e festivalit folklorik "I Këndojmë Lirisë"

Pika 1. Shqyrtimi i planit të punës për ekipin komunal për të drejtat e fëmijës 2024-2026.

-Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, nga grupi punues referoi z. Astrit Muhaxheri i cili theksoi se Hartimi i këtij Plani për të Drejtat e Fëmijëve në Komunën e Klinës shërben si dokument për përmirësimin e kushteve të jetesës dhe të drejtave të fëmijëve në qytetin tonë. Rritja dhe ofrimi i kapaciteteve për një mjedis të sigurt dhe të mbrojtur për fëmijët është edhe qëllimi kryesor i këtij dokumenti. Me këtë dokument synojmë të rrisim ndërgjegjësimin rreth të drejtave të fëmijëve dhe të adresojmë sfidat që ata përballen në jetën e tyre të përditshme. Po ashtu, në kuadër të këtij plani është edhe plani i veprimit për zbatimin e këtij plani 2024-2026 dhe kërkoi që i njëjti të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të draft-planit të punës për ekipin komunal për të drejtat e fëmijës 2024-2026, rekomandoi që deri në mbajtjen e seancës të verifikohen dhe të analizohet plani i veprimit për zbatimin e këtij plani, pasi që ka kosto financiare. Po ashtu, u rekomandua që i njëjti të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Pika 2. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit i Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, për vënie në diskutim publik draft-rregulloren për taksa, tarifa dhe ngarkesa të tjera komunale.

-Sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, Komiteti për Politikë dhe Financa, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim, rekomandoi që draft-rregullorja për taksa, tarifa dhe ngarkesa të tjera komunale të kalojë për shqyrtim në Kuvend dhe të merret vendim për ta vënë në diskutim publik.

Pika 3. Shqyrtimi i propozim-vendimit të DKRS-së për ndarje të mjeteve financiare për mbajtjen e festivalit folklorik “I Këndojmë Lirisë”

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës së Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, për ndarje të mjeteve financiare në shumë prej 25 mijë euro për mbajtjen e festivalit folklorik “I Këndojmë Lirisë” rekomandoi që kërkesa të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

4. Të ndryshme.

Kërkesa 1.

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas kërkesave të anëtarëve të këtij komiteti, rekomandoi që Drejtoria e Arsimit, në seancën e cila do të mbahet në muajin mars të informojë kuvendin në lidhje me zbatimin e rregullores dhe udhëzimeve të tjera administrative për masat të cilat ndalohen me ligj e posaçërisht përdorimi i telefonave mobil.

Kërkesa 2.

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas kërkesave të anëtarëve të këtij komiteti, rekomandoi që Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjente në seancën e cila do të mbahet në muajin mars të informojë kuvendin në lidhje me trajtimin e qenëve endacakë.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA

www.komuna-kline.org



PLANI I PUNËS PËR
EKIPIN KOMUNAL PËR TË DREJTAT E
FËMIJËS - KLINË
(2024 – 2026)

Klinë, 2024

Përmbajtja

Parathënie.....	3
Hyrje	3
Konteksti Global, Nacional e Lokal	6
Parimet dhe vlerat	7
Qëllimi jonë	9
Fushat e veprimit	9
Objektivat, Masat e Veprimet.....	10
OBJEKTIVI 1: Ofrimi i shërbimeve cilësore gjithëpërfshirëse për fëmijët në komunë.....	10
OBJEKTIVI 2: Zbatimi i programeve të vetëdijesimit dhe avokimit për mirëqenien e fëmijëve.....	14
OBJEKTIVI 3: Krijimi i hapësirave publike të sigurt dhe miqësore për fëmijët.....	16
OBJEKTIVI 4: Zhvillimi i fëmijëve përmes sporteve, lojës dhe rekreacionit....	17
OBJEKTIVI 5: Sigurimi i pjesëmarrjes së fëmijëve në proceset vendimmarrëse për çështjet që lidhen me jetën e tyre.....	18
OBJEKTIVI 6: Bashkërendimi i veprimeve të të gjitha palëve përmes procesit të koordinimit, si dhe përmes vlerësimit dhe raportimit për gjendjen e fëmijëve në komunë	20
Plani i Veprimi.....	21
Shtojca: Plani i detajuar i veprimit	28

1 PARATHËNIE

FJALA E KRYETARIT

Hartimi i këtij Plani për të Drejtat e Fëmijëve në Komunën e Klinës shërben si dokument për përmirësimin e kushteve të jetesës dhe të drejtave të fëmijëve në qytetin tonë.

Rritja dhe ofrimi i kapaciteteve për një mjedis të sigurt dhe të mbrojtur për fëmijët është edhe qëllimi kryesor i këtij dokumenti. Me këtë dokument synojmë të rrisim ndërgjegjësimin rreth të drejtave të fëmijëve dhe të adresojmë sfidat që ata përballen në jetën e tyre të përditshme.

Ne jemi të përkushtuar që prioritetet dhe qëllimet për të drejtat e fëmijëve të jenë kyçe në plan për përmirësim në Arsim duke ndërmarrë masa për të siguruar qasje të barabartë dhe arsim cilësor për të gjithë fëmijët pa dallim.

Me zbatimin e këtij Plani mundësohet arritja e misionit për të Drejtat e Fëmijëve dhe zhvillimi i programeve të cilat krijojnë ambiente të sigurta dhe të përshtatshme mësimore me cilësi të lartë e të vazhdueshme dhe të qasshme nga të gjithë fëmijët, duke mos harruar asnjëherë përkrahjen e fëmijëve me nevoja të veçanta.

Në vazhdimësi do të kujdesemi t'i mbrojmë fëmijët nga dhuna dhe abuzimi, duke mos toleruar asnjë formë të dhunës apo abuzimit ndaj fëmijëve, dhe do të ndërmarrim masa për të ndërgjegjësuar komunitetin për të siguruar ndihmë dhe mbrojtje të menjëhershme për fëmijët që janë viktimë të dhunës.

Pa dyshim që nuk do e lejmë pas promovimin e shëndetit dhe mirëqenies, duke përmirësuar shëndetin dhe mirëqenien e fëmijëve në komunën tonë. Në programin tonë për arsim, shëndetësi, mirëqenie dhe barazi kemi plan të organizojmë programe shëndetësore parandaluese, duke frymëzuar ushqyerjen e shëndetshme dhe aktivitete fizike, si dhe do të ofrojmë me anë të një platforme *online* Konsultime me mundësi anonimiteti me psikologun për të gjithë ata që kanë nevojë, posaçërisht për fëmijët dhe familjet e tyre.

Ne nuk do të ndalemi asnjëherë në bërjen e investimeve edhe në infrastrukturën sportive e cila do të frymëzojë më shumë aktivitete sportive në të gjitha moshat, duke ndërtuar fusha të futbollit dhe duke ofruar hapësira të reja për talentët e rinj të sportit. Do të organizohen vazhdimisht aktivitete sportive, kulturore dhe rinore për fëmijët, duke i frymëzuar ata të zhvillojnë pasionet e tyre por edhe në infrastrukturën e shkollave dhe mjeteve të duhura për të përmbushur nevojat e fëmijëve, si dhe të ndërtojmë mekanizma mbrojtëse për t'i shpëtuar ata nga dhuna dhe rreziku i mundshëm.

Për fëmijët tanë, duhet të jemi një, të gjithë së bashku, për të siguruar qëndrueshmëri të plotë e afatgjatë për të drejtat e fëmijëve dhe mirëqenien e tyre.

Mirënjohje dhe falënderim i veçantë për përkushtimin dhe angazhimin e hartuesve të Planit të Punës për Ekipin Komunal për të Drejtat e Fëmijës në Klinë (2024-2026).

Sinqerisht,
Zenun Elezaj - Kryetar i Komunës së Klinës

2 HYRJE

Komuna e Klinës në kuadër të politikave zhvillimore për të përmirësuar jetën e qytetarëve të saj, rëndësi shumë të veçantë i kushton investimit në fëmijë dhe në interesin më të mirë të tyre, konform obligimeve ligjore, Ligji Nr. 06/L-084 Për Mbrojtjen e Fëmijës¹, Udhëzimin Administrativ (QRK) 06/2022 për Themelimin dhe Funksionimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës² dhe Profili i Komunave të Kosovës.

Përmes këtij Plani të punës ne si komunë zotohemi dhe do të angazhohemi vazhdimisht në garantimin e mirëqenies dhe përmirësimit të cilësisë së jetës së fëmijës, duke promovuar e mundësuar zhvillimin e tyre në shoqëri, ndihmën dhe përkujdesjen efektive, shëndetësi dhe arsimit cilësor. Marrjen e masave për t'i siguruar secili fëmijë në komunën tonë ushtrimin e të drejtave në përputhje me zhvillimin gradual të aftësive, bazuar gjithnjë në interesin më të mirë të tyre.

Zhvillimin dhe fuqizimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve në nivel lokal, si dhe organizatave për mbrojtjen e fëmijës, prindërit dhe vetë strukturat fëmijëve, këshillat e nxënësve apo asamblenë e fëmijëve dhe mekanizmat përgjegjës në nivel nacional.

Si Komunë ne jemi të përcaktuar të angazhohemi në vazhdimësi në parandalimin e hershëm të dhunës dhe dukurive të tjera, mbrojtjen dhe ofrimin e kushteve dhe mundësinë që fëmijët e komunës sonë të gëzojnë të drejtat që ju garantohen me Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijës dhe Strategjinë e Bashkimit Evropian për të Drejtat e Fëmijës, (2021)³ në ofrimin e kushteve për zhvillim të plotë të tyre. Ky përcaktim, reflektohet në politikën tonë qeverisëse e cila është miqësore për ta, që komuna e Klinës të jetë komunë miqësore për të gjithë fëmijët.

Plani i punës trevjeçar (2024-2026) do të shërbejë si dokument pune për ekipin komunal për të drejtat e fëmijës, si një mekanizëm gjithëpërfshirës i themeluar së voni nga komuna për të hartuar politika praktike në lidhje me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës. Plani i punës është hartuar në përputhje me praktikën e promovuar të qyteteve mike për fëmijë dhe përmban

¹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=20844>

² <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=61596>

³ https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/IP_21_1226

fusha të ndryshme të veprimit, të nevojshme për të siguruar realizimin e të drejtave të fëmijës dhe mbrojtjen e tyre kudo.

Procesi i hartimit të këtij plani ka qenë një proces dinamik me pjesëmarrje të gjerë, përfshirë sektorët komunalë në konsultim me institucionet qendrore, Ministrinë e Administrimit Lokal, organizatat lokale që punojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve, “Syri i Vizionit”, si dhe vetë fëmijët përfaqësuar nga Këshilli i nxënësve dhe kryetarin e Këshillit të prindërve në cilësinë e vëzhguesit në kuadër të Ekipit për të Drejtat e Fëmijës.

Disa nga veprimet që i kanë paraprirë hartimit të kësaj strategjie janë:

-Takimi informues për ekipin dhe punën e ekipit;

- Janë organizuar konsultime paraprake me palë të ndryshme që kanë ndihmuar në mbledhjen e informatave themelore dhe përgatitjen e procesit të planifikimit;
- Është organizuar një punëtori njëditore e planifikimit me pjesëmarrje, ku janë identifikuar fushat e veprimit, si dhe është përcaktuar logjika e intervenimit.

I gjithë procesi është udhëhequr nga Kryesuesi i Ekipit për të Drejtat e Fëmijës, njëherësh kryetari i komunës së Klinës, z. Zenun Elezaj dhe zëvendëskryesuesja e Ekipit, znj. Marqe Selmanaj, nënkryetare e komunës, ndërsa përkrahje profesionale dhe administrative është ofruar nga z.Astrit Muhaxheri, zyrtar për Mbrojtjen e Fëmijëve në Komunën e Klinës, njëherësh koordinator i ekipit komunal për të drejtat e fëmijëve.

3 KONTEKSTI GLOBAL, NACIONAL E LOKAL

Pa dyshim se Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës⁴ është bazamenti i secilit veprim në fushën e të drejtave të fëmijëve. Parimet e saj janë të përqafuara në politika ndërkombëtare që prekin jetën e fëmijëve, por edhe në politikat vendore e lokale. Detyrimisht, edhe ky plan i punës është ndërtuar mbi parimet udhëheqëse të Konventës.

Në nivel vendi, veprimi për të drejtat e fëmijës dhe mbrojtjen e fëmijës është planifikuar përmes strategjive. Objektivi i dytë strategjik në këtë strategji kërkon që qeverisja lokale t'i prioritetizojë të drejtat e fëmijëve, duke synuar përmirësimin e jetës së fëmijëve brenda

⁴ <https://www.unicef.org/montenegro/media/9291/file/MNE-media-MNEpublication505.pdf>

juridiksionit të tyre në përputhje me obligimet që rrjedhin nga Konventa për të Drejtat e Fëmijës dhe korniza ligjore vendore.

Kosova për herë të parë më 17 korrik të vitit 2019 ka miratuar Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës⁵, duke hapur rrugën e operacionalizimit të tij përmes akteve nënligjore dhe krijimit e funksionimit të mekanizmave mbrojtës për fëmijët. Kështu ndër të tjera përcakton që Ekipi për të Drejtat e Fëmijës krijohet në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës në nivel të vendimmarrjes politike. Në nenin 20 jepen edhe konturat e fushëveprimit të këtij ekipi. Në vitin 2022, Qeveria e Kosovës ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ 06/2022⁶ për themelimin dhe funksionimin e ekipit për të drejtat e fëmijës, që përcakton mënyrën e themelimit dhe aspektet e funksionimit të këtij ekipi.

Kryetari i Komunës, në përputhje me UA 06/2022, më 15.11.2023 ka nxjerrë vendim për themelimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës.

Ky plan trevjeçar i punës i Ekipit për të Drejtat e Fëmijës është hartuar në përputhje me parimet e Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës, me politikat e nivelit qendror e lokal, si dhe me konceptin e komunave mike për fëmijë.

4 PARIMET DHE VLERAT

Komuna e Klinës njihet si institucion model i qeverisjes lokale që u shërben njësoj të gjithë qytetarëve të vet pa dallime, duke u ofruar në të njëjtën kohë mundësi të gjithëve të shprehin potencialin e tyre dhe të kontribuojnë aktivisht në mirëqenien e përgjithshme shoqërore. Një model i këtillë promovohet edhe në raport me fëmijët, ku promovohen dhe realizohen të drejtat e tyre, për arritjen e potencialit të plotë, në përputhje me standardet ndërkombëtare, kushtetutën dhe legjislacionin në Republikën e Kosovës.

⁵ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=20844>

⁶ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61596>

Fëmijët do të përfshihen në proceset komunale që lidhen me jetën e tyre dhe duke krijuar kushtet që të zhvillojnë gjithë potencialin e tyre. Si ekip e si komunë, jemi të përcaktuar që proceset në komunë të jenë jo vetëm “për fëmijët” por edhe “me fëmijët”.

Në punën tonë si ekip, udhëhiqemi nga parimet themelore të të drejtave të fëmijëve të cilat janë të përcaktuara në Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat e Fëmijës:

- **Mosdiskriminimi** - të gjithë fëmijët duhet t'i gëzojnë të gjitha të drejtat. Asnjë fëmijë nuk duhet ta vuaj diskriminimin mbi çfarëdo baze.
- **Interesat më të mira të fëmijës** - kur merren vendime që ndikojnë në fëmijët, interesave më të mira të fëmijës duhet t'u jepet vëmendje parësore.
- **Jeta, mbijetesa dhe zhvillimi** – të gjithë fëmijëve duhet t'u sigurohet mbijetesa dhe zhvillimi deri në masën më të madhe të mundshme. Zhvillimi përfshin edhe dimensionin e cilësisë: jo vetëm shëndeti fizik, por edhe zhvillimi mental, emocional, kognitiv, social dhe kulturor.
- **Pikëpamjet e fëmijës** - fëmijët duhet të jenë të lirë të shfaqin pikëpamjet lidhur me çdo çështje që ndikon në ta dhe këtyre pikëpamjeve duhet t'u jepet peshë e duhur në përputhje me moshën dhe pjekurinë e fëmijëve.

Ndërtimi i komunës mike për fëmijë bëhet përmes **vlerave të përbashkëta**, vlera këto që ndërliken me komunën, ku fëmijët:

- Dëgjohen dhe bëhen pjesë e vendimmarrjes;
- Janë të mbrojtur nga të gjitha llojet e dhunës e keqtrajtimit dhe ndëshkimit trupor;
- Ndihen të sigurt kudo;
- Luajnë e argëtohen;
- Përfshihen lirisht;
- Krijojnë miqësi dhe ndihen të lidhur me komunitetin;
- Kanë mundësi për të mësuar dhe për të zhvilluar shkathtësitë;
- Ndihen të vlerësuar e respektuar;
- Krijojnë ndjenjën e përgjegjësisë ndaj vetes dhe të tjerëve.

5 QËLLIMI JONË

Qeverisje komunale që siguron mbrojtjen, zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijëve, përmes krijimit dhe zhvillimit të një sistemi bashkëveprues të të gjithë sektorëve komunalë dhe bashkëpunimit me të gjitha palët.

Ne do të ofrojmë një model të qeverisjes lokale që vazhdimisht do të mbizotërojnë interesat më të mira të fëmijëve të komunës sonë. Përmes bashkëveprimit dhe mirë koordinimit të punëve ndërmjet gjithë sektorëve komunalë, ne do të ofrojmë shërbime shumëdimensionale për fëmijë. Në të gjitha fushat e veprimit do të krijojmë lidhje bashkëpunimi me partnerët dhe komunitetin, që fëmijëve t'u krijojmë një mjedis jetësor e të këndshëm dhe mundësues. Rëndësi, vazhdimisht do t'i kushtojmë përfshirjes aktive të vetë fëmijëve në të gjitha proceset vendimmarrëse në komunë që lidhen me jetën dhe interesin me të mirë të tyre. Kështu duke investuar në fëmijë do të ndikojmë që në të ardhmen këta fëmijë do të bëhen qytetarë të përgjegjshëm.

6 FUSHAT E VEPRIMIT

Janë identifikuar gjashtë fusha të veprimit në kuadër të planit të punës. Këto fusha, ndonëse janë të veçanta, në asnjë mënyrë nuk mund të adresohen si të vetme. Përkundrazi, ato janë të lidhura ngushtë në mes veti dhe e plotësojnë njëra-tjetrën, duke e bërë planin e punës koherent e gjithëpërfshirës.

1. Shërbimet cilësore e gjithëpërfshirëse për fëmijë

2. Vetëdijesimi dhe avokimi për fëmijë

3. Hapësirat e sigurt e miqësore për fëmijë

4. Sporti, loja dhe rekreacioni për fëmijë

7 OBJEKTIVAT, MASAT E VEPRIMET

Këto fusha prioritare janë përkthyer në objektiva strategjike dhe më tutje përmbajnë masa që përmbushin këto objektiva. Secila masë brenda objektivit përkatës është zbërthyer më tutje në veprime konkrete, që shërbejnë si udhërrëfim në fazën e zbatimit të planit të punës.

7.1 OBJEKTIVI 1: OFRIMI I SHËRBIMEVE CILËSORE E GJITHËPËRFSHIRËSE PËR FËMIJËT NË KOMUNË

Ne duam të ofrojmë dhe përmirësojmë shërbimet e sektorëve si mirëqenia sociale, arsimi, shëndetësia, shërbimet publike, sport e rekreacion, duke u ofruar fëmijëve të komunës sonë kushtet më të mira të mundshme dhe duke e mbështetur zhvillimin e plotë të potencialit të tyre. Në këta sektorë respektivë do të identifikohen nevojat specifike dhe llojet e shërbimeve bazë të cilat duhet të përmirësohen apo edhe ofrimin e shërbimeve shtesë. Vëmendje e veçantë do t'u kushtohet kategorive më të cenueshme të fëmijëve, siç janë: fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët nga familjet që janë përfitues të skemës së ndihmës sociale, fëmijët lëmoshë kërkues apo fëmijët në rrethana të jashtëzakonshme, etj.

Krahas ofrimit të shërbimeve për fëmijët, do të ofrohet mbështetje për familjet dhe komunitetin përmes edukimit, sikurse edhe do të zhvillohen kapacitetet e profesionistëve të fushave të ndryshme që ta përmirësojnë cilësisë e shërbimeve që ofrojnë.

1.1 Krijimi i një sistemi informues shumëdimensional për llojet e shërbimeve sociale në komunë

Do të krijohet një sistem për të mbajtur publikun të informuar për të gjitha shërbimet që ofrohen në komunë. Fillimisht do të bëhet evidentimi i të gjitha shërbimeve ndaj fëmijëve. Më tutje do të zhvillohet një katalog i llojeve të shërbimeve sociale që ofrohen dhe i ofruesve të shërbimeve si dhe të drejtat e qytetarëve që të kenë qasje në këto shërbime. Do të organizohet një fushatë sensibilizuese për të rritur vetëdijen e qytetarëve përmes institucioneve publike, mediave lokale, ueb-faqes së komunës dhe kanaleve tjera të komunikimit.

1.2 Rritja e fondit për fëmijët në rrethana të jashtëzakonshme

Fëmijët që gjenden në rrethana të jashtëzakonshme kërkojnë përkrahje emergjente institucionale në kuptim të ofrimit të shërbimeve profesionale ndërsektoriale, por edhe ofrimit të shërbimeve logjistike, siç janë: ushqimi, transporti, akomodimi, etj. Për këtë arsye do të bëhet rritja e fondeve për këta fëmijë dhe do të krijohet një sistem unifikues ndërsektorial për menaxhimin e këtij financimi dhe këtyre shërbimeve emergjente. Do të evidentohen nevojat për shërbime emergjente dhe do të kontraktohen operatorët ekonomikë për ofrimin e këtyre shërbimeve.

1.3 Mbështetja dhe Fuqizimi i familjeve strehuese dhe farefisnore

Koncepti i familjeve strehuese dhe farefisnore është provuar si i suksesshëm, prandaj edhe është i paraparë me Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës. Përpos që do të mbështesim familjet ekzistuese do të promovojmë si shërbim dhe do të ndërmarrim një fushatë për të rritur numrin e këtyre familjeve.

1.4 Programe për prindër në prindërimin e përditshëm dhe disiplinën pozitive

Organizimin e sesioneve me prindër në prindërimin e përditshëm sipas moduleve ekzistuese të prindërimit të mirë do të përshtaten për nevoja të komunitetit. Po ashtu, do të krijohen kapacitetet njerëzore për ofrimin e moduleve të trajnimit dhe do të shpërndahen praktikat e prindërimit të mirë përmes trajnimeve e sesioneve të informimit me psikologë e pedagogë të shkollës, që më pas këta të ofrojnë këto sesione për prindërit e shkollës së tyre.

1.5 Ofrimi i mundësive të barabarta për të gjithë fëmijët për t'u regjistruar, vizuar dhe përfunduar shkollën

Arsimi i obligueshëm nënkupton që çdo fëmijë i moshës shkollore ta vijojë shkollimin, edhe pse komuna jonë ballafaqohet me raste të mosregjistrimit, mosvijimit të rregullt dhe braktisjes së shkollimit. Do të fuqizohet komunikimi mes shkollave dhe zyrave të regjistrimit civil dhe mundësitë për krijimin e një sistemi për t'i marrë të dhënat e fëmijëve të moshës shkollore nga zona që gravitojnë shkollat, në mënyrë që të lehtësohet procesi i regjistrimit në shkollë. Shkollat do të obligohen që të mirëmbajnë dhe përditësojnë me informata të nevojshme bazën e të dhënave me të dhëna për nxënësit sipas modelit të Sistemit të Menaxhimit të Informatave në Arsim (SMIA). Ekipet për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit (EPRBM) do të krijohen në të gjitha shkollat si dhe do të bashkëpunohet ngushtë me organizatat që punojnë në fushën e gjithëpërfshirjes në arsim. Drejtoria e Mirëqenies Sociale, në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit, Qendrën për Punë Sociale, organizata të ndryshme, aty ku kemi informata që ata fëmijë nuk po ju qasen apo nuk vijojnë procesin mësimor shkaku i kushteve ekonomike, mundohemi që t'i përkrahim me mjete shkollore në mënyrë që ata fëmijë të ju kthehen bankave shkollore.

1.6 Ofrimi i shërbimeve profesionale nëpër shkolla

Do të trajnohen mësimdhënësit për identifikimin e hershëm të fëmijëve në nevojë për shërbime profesionale pedagogjike, logopedike dhe psikosociale si dhe krijohet/funksionalizohen mekanizma për referimin e fëmijëve në nevojë për shërbime profesionale. Po ashtu, do të identifikohen nevojat për mësimdhënës mbështetës për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe do të angazhohen këta mësimdhënës në secilën shkollë të komunës sonë. Duke respektuar këtë të drejtë, DKA në bashkëpunim me DSHMS-në në Klinë, ka ndërmarrë të gjitha hapat për të ofruar shërbime për këtë kategori të fëmijëve në çerdhe-kopshte si dhe në shkolla.

1.7 Inspektimi i cilësisë së hapësirave dhe pajisjeve shkollore

Gjendja e objekteve shkollore ndikon shumë në cilësinë e arsimit. Prandaj, ekipet profesionale do ta inspektojnë gjendjen e shkollave (inspektim të vjetërsisë së objekteve, sanitarisë, hapësirave për lojë e rekreacion, pajisjeve shkollore, etj). Këto ekipe do të inspektojnë objektet shkollore në baza vjetore dhe do të dalin me raporte vlerësuese.

Mbështetur në të dalat e raporteve do të ndërmerren masa për investim me qëllim të krijimit të objekteve dhe mjediseve shkollore miqësore e të sigurta për fëmijë. Vazhdimisht do të promovohen standardet e shkollave të sigurta e mike për fëmijë.

1.8 Promovimi shëndetësor dhe i të ushqyerit shëndetshëm

Do të promovohet shëndeti përmes fushatës vetëdijesuese për shëndetin dhe të ushqyerit e foshnjave, fëmijëve dhe adoleshentëve, si dhe përmes edukimit shëndetësor të qytetarëve e ligjëratave për edukimin shëndetësor dhe reprodutiv për nxënësit e shkollave. Po ashtu, do të organizohen ligjërata për parandalimin e abuzimit me substanca narkotike.

1.9 Organizimi i vizitave multidisiplinare shëndetësore për fëmijët, në baza periodike

Në bashkëpunim me organizatat vendore e ndërkombëtare do t'i kushtohet kujdes ofrimit të shërbimeve të individualizuara shëndetësore për secilin fëmijë. Prandaj do të zhvillohen kapacitetet e profesionistëve shëndetësorë për kujdes shëndetësor ndaj nënës dhe fëmijës, këshillim për të ushqyerit e foshnjave dhe fëmijëve të vegjël dhe përkrahje të zhvillimit në fëmijërinë e hershme. Do të organizohet shërbimi i vizitave sistematike nëpër shtëpi, të cilat do të kenë përveç komponentit të intervenimit shëndetësor edhe atë edukativ. Do të zbatohen praktikat efektive të kujdesit perinatal dhe vizitave për nënat dhe fëmijët. Kontrollat sistematike shëndetësore do të realizohen edhe nëpër shkolla.

1.10 Identifikimi i hershëm i fëmijëve me aftësi të kufizuara

Do të krijohet dhe përditësohet baza e të dhënave për fëmijët me aftësi të kufizuara. Do të promovohen shërbimet institucionale dhe ato të ofruesve të tjerë të shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara. Do të hartohet dhe përdoret një formular për deklarimin e prindit për gjendjen shëndetësore të fëmijës së tij/saj, gjatë regjistrimit në shkollë. Për ata fëmijë që kanë parametra që identifikojnë nevojën për kontroll më të hollësishëm, do të ndërmerren vlerësime dhe do të rekomandohen masa që duhet ndërmarrë shkolla (mësimdhënësit, menaxhmenti i shkollës, psikologu/ja, prindërit). Po ashtu, një data-bazë e fëmijëve në institucionet parashkollore me nevojat e ofrimit të shërbimeve logopedike është bërë dhe do realizohen fushata me prindër.

1.11 Ofrimi i shërbimeve të veçanta për kategoritë e fëmijëve në nevojë

Do të ofrohen shërbime shumëdimensionale dhe rehabilitim i bazuar në bashkësi për fëmijët në nevojë dhe atyre me aftësi të kufizuara, përmes subvencionimit të organizatave të licencuara për ofrimin e këtyre shërbimeve. Do të krijohen kushte dhe mundësi për qasje fizike të fëmijëve me aftësi të kufizuara në hapësirat publike duke i paraprirë me identifikimin e nevojave për intervenime në qasjen fizike. Po ashtu, do të ofrohen programe të mbështetjes shtesë për fëmijët nga grupet e cenueshme (komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, fëmijët në situatë rrugë/lëmoshëkërkuesit, fëmijët që punojnë, fëmijët viktimë të trafikimit, etj.). Programe të tilla do të jenë mësimi shtesë përmes qendrave mësimore në komunitet, përfshirja në aktivitete rekreative të qendrave rinore, sesione këshillimi, etj.

7.2 OBJEKTIVI 2: ZBATIMI I PROGRAMEVE TË VETËDIJESIMIT DHE AVOKIMIT PËR MIRËQENIEN E FËMIJËVE

Ne do të punojmë dhe angazhohemi vazhdimisht që në bashkëpunim me partnerët tanë, të krijojmë një sistem efektiv për të vetëdijesuar të rriturit, por edhe vet fëmijët për të drejtat e fëmijëve, mirëqenien e tyre dhe krijimin e një komune mike për ta. Programet për informim dhe zhvillim profesional për të gjitha palët duke përfshirë edhe politikëbërësit e zyrtarët më të lartë komunalë, janë të një rëndësie të veçantë. Në të njëjtën kohë, ne do t'i inkurajojmë organizatat e shoqërisë civile, agjencitë e pavarura që të avokojnë për fëmijët dhe me fëmijët. Mediat lokale elektronike, ueb-faqet dhe rrjetet sociale do të shfrytëzohen në promovimin e vazhdueshëm për të drejtat e fëmijëve dhe pjesëmarrjen në vendimmarrje aty ku preket interesi më i mirë i tyre.

2.1 Ngritja e kapaciteteve të politikëbërësve dhe zyrtarëve komunalë për aspekte të të drejtave të fëmijëve.

Ngritja e njohurive mbi të drejtat e fëmijës është e rëndësishme për të ndërgjegjësuar dhe përgatitur ata për të kuptuar dhe zbatuar me efikasitet politikat dhe veprimet që kanë ndikim në mirëqenien dhe zhvillimin e fëmijëve. Prandaj, do të organizohen trajnime për ta në temat e njohjes dhe promovimit të të drejtave të fëmijëve, instrumenteve ndërkombëtare, legjislacionit dhe rregullativës që lidhet me të drejtat e fëmijëve, vlerësimit dhe raportimit të gjendjes së fëmijëve, standardeve të operimit, investimit publik në fëmijë, etj. Këto trajnime mund të ndihmojnë në përmirësimin e qëllimeve dhe strategjive të qeverive vendore për të garantuar dhe mbrojtur të drejtat e fëmijëve.

2.2 Organizimi i fushatave vetëdijesuese për të rriturit dhe për fëmijët

Qytetarët duhet të vetëdijesohen për atributet e komunës mike për fëmijë dhe të aktivizohen si qytetarë të përgjegjshëm, përmes zhvillimit të fushatave dhe kampanjave vetëdijesuese për të rritur dhe fëmijë. Fushatat do të përfshijnë ligjëratat publike, shpërndarjen e materialit promovues, emisione në TV e radio, mesazhe promovuese përmes rrjeteve sociale etj.

2.3 Mbështetja e organizatave joqeveritare dhe institucioneve të pavarura në avokimin për të drejtat e fëmijës

Ne do të mbështesim dhe do të jemi aktiv në aktivitet avokuese që realizohen nga organizatat joqeveritare, koalicionet e rrjetet që monitorojnë, promovojnë dhe mbrojnë të drejtat e fëmijëve. Do të përkrahet puna e tyre dhe do të mundësohet e përkrahet puna e vetë organizatave të fëmijëve dhe të rinjve apo që punojnë me këto kategori në avokimin për të drejtat e tyre. Do t'i subvencionojmë organizatat të cilat merren me këto kategori dhe t'i mbështesim projektet e tyre, ku përmes këtyre projekteve do të kontribuojnë në ngritjen e mirëqenies së jetës së fëmijëve në komunën tonë.

2.4 Promovimi i të drejtave të fëmijëve përmes mediave

Mediat do të jenë një ndër mekanizmat shumë me rëndësi në promovimin e të drejtave të fëmijëve, për të publikuar lajme dhe storie në interesin më të mirë të tyre, ku do të ofrohen udhëzues dhe trajnime për zyrën e informimit dhe marrëdhënieve me publikun, për sekretariatit e ekipit si dhe për mediat e profesionistët e mediave të shkruara dhe elektronike në komunën tonë. Mediat dhe organizatat që punojnë në fushën e të drejtave të fëmijëve apo ofrojnë shërbime për fëmijë, do të trajtohen si partnerë dhe përkrahen që të promovojnë të drejtat e fëmijëve dhe organizohen forume diskutimi në mes komunës dhe mediave lidhur me standardet për mbrojtjen e identitetit dhe integritetit që të paraqesin gjendjen e fëmijëve në mënyrë transparente e reale.

7.3 OBJEKTIVI 3: KRIJIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE TË SIGURTA DHE MIQËSORE PËR FËMIJËT

Ne do të angazhohemi që të gjitha hapësirat publike ku frekuentojnë fëmijët e komunës sonë të jenë plotësisht të parrezikshme për ta dhe t'u krijojnë atyre ndjenjën e sigurisë në çdo kohë, edhe atëherë kur janë vetëm. Fëmijët dhe prindërit do të përfshihen aktivisht në konsultime gjatë rregullimeve urbanistike, higjienës kolektive, do të krijojnë kushte për lëvizje të lirë e të qasshme në trotuare dhe siguri në trafik.

3.1 Sigurimi i sistemit të trafikut që është i sigurt dhe miqësor për fëmijët

Komuna jonë vazhdimisht është e angazhuar të punojë në krijimin e hapësirave të duhura të trafikut, pasi që përballemi me një trafik të ngarkuar nga numri i madh i makinave dhe hapësirave për parkingje të pamjaftueshme si dhe të zhvillohen trotuare apo shtigje shtesë për këmbësorë e biçiklistë. Do të hartohen dhe zbatohen projekte për lirim të trotuareve dhe vendkalimeve për këmbësorë, vendosjen e shenjave të vendkalimeve dhe pjerrina, vendosjen e barrierave (polic të shtrirë), shtigjeve të biçiklistëve, etj. Të sigurohet hapësira brenda në oborrin e shkollave për mjetin e transportit të nxënësve të kontraktuar nga Drejtoria e Arsimit. Po ashtu, Drejtoria e Arsimit planifikon që shumë shpejt të sigurojë transportin për të gjithë nxënësit e shkollimit obligativ.

3.2 Eliminimi i rreziqeve dhe krijimi i mjedisit ekologjik

Duke vlerësuar rreziqet në hapësirat publike në afërsi të shkollave ku kemi numrin më të madh të fëmijëve do të merren masa për të parandaluar rreziqet e mundshme përreth shkollës, që mund të vijnë nga prania e personave të dyshimtë, shitja e artikujve të dëmshëm si dhe qentë endacakë.

7.4 OBJEKTIVI 4: ZHVILLIMI I FËMIJËVE PËRMES SPORTEVE, LOJËS DHE REKREACIONIT

Zhvillimi i fëmijëve dhe talentet që kanë përmes një segmenti shumë të rëndësishëm, siç janë loja, rekreacioni dhe sporti, janë elemente të rëndësishme ku ata shfaqin talentet e tyre. Do të promovohet pjesëmarrja e fëmijëve nëpër klube sportive e institucione kulturore dhe shkolla, pasi që shkollat do të krijojnë lidhjet me klubet sportive, klubet artistike e kulturore, në mënyrë që fëmijët të mund t'i zhvillojnë më tutje talentet e tyre në fushat në të cilat kanë interesim. Hapësirat publike do të adaptohen që të sigurojnë argëtim e kohë të lirë për fëmijët nëpër lagje.

4.1 Promovimi i sportit dhe krijimi i klubeve në shkolla

Në shkollat e komunës sonë, rëndësi do t'i kushtohet promovimit të sportit dhe së bashku me shkollën dhe klubet sportive do të krijohen edhe klubet sportive në nivel të shkollave dhe do të organizohen gara e ekspozita shkollore në sporte të ndryshme. Gjatë promovimit të sportit dhe zhvillimit të garave, rëndësi do t'i kushtohet përfshirjes gjinore dhe thyerjes së stereotipeve gjinore në fushën e sportit, pasi që komuna jonë njihet edhe për klube sportive në kategorinë e femrave dhe jo vetëm meshkujve.

4.3 Promovimi i artit, kulturës dhe teknologjisë

Programe artistike e kulturore do të organizohen nëpër shkolla, ku fëmijët do të demonstrojnë shkathtësitë e tyre duke i ndërlidhur edhe me shoqatat kulturore e artistike si: teatro, ansamble të këngëve e valleve, klube letrare, ekspozita me punime artistike të

nxënësve të shkollave fillore, etj. Do të përkrahen shkollat dhe institucionet në promovimin e hapësirave për teknologji informative dhe IT në programim, kodim, ueb, dizajn, etj.

4.4 Ofrimi i hapësirave joformale për rekreacion

Ne do të angazhohemi që të intervenohet në adaptimin e hapësirave ekzistuese për lojë dhe në ndërtimin e hapësirave të reja në ato lagje e fshatra ku është e mundur krijimi i hapësirave të tilla. E gjithë kjo do të bëhet në përputhje me standardet e hapësirave të sigurta e mike për fëmijë. Do të krijohet një partneritet mes komunës dhe komunitetit apo organizatave joqeveritare që ofrojnë aktivitete joformale e rekreative duke krijuar ekipet e përbashkëta për krijimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave rekreative. Për t'i kthyer këto hapësira komunitare në hapësira përfshirëse, do të bëhet identifikimi i nevojave për rekreacion i fëmijëve me nevoja të veçanta dhe përfshirja e tyre në parqet ekzistuese.

4.5 Angazhimi i fëmijëve në aktivitete të lira dobiprurëse për komunitetin

Po aq me rëndësi është që fëmijëve t'u ofrohen mundësi që këtë kohë rekreacioni ta shfrytëzojnë për aktivitete që janë me përfitim për komunitetin. Kësisoj, ata i zhvillojnë vlerat qytetare dhe përgjegjësinë për komunitetin. Komuna do të përkrahë organizimin e kampeve me fëmijë dhe të rinj nga shkollat e ndryshme, por edhe atyre nga organizatat e fëmijëve. Këto kampe do të jenë të natyrës rekreative, edukative, mjedisore, etj. Do të organizohen vizita e takime edukative e kulturore në institucionet që mbrojnë të drejtat e fëmijëve. Më tutje, do të bëhet angazhimi i fëmijëve dhe të rinjve në aktivitete në përfitim të komunitetit si mbjellja e drunjve, ofrimi i ndihmës së parë, evakuimi, siguria në trafik, etj.

7.5 OBJEKTIVI 5: SIGURIMI I PJESËMARRJES SË FËMIJËVE NË PROCESET VENDIMMARRËSE PËR ÇËSHTJET QË LIDHEN ME JETËN E TYRE

Ne duam që fëmijët në varësi të kapacitetit të tyre, të marrin pjesë aktivisht në vendimet për komunën, sidomos në ato që lidhen drejtpërdrejt me jetën e tyre. Do të ndihmojmë edhe familjet që të ndjekin këtë qasje që nga fëmijëria e hershme, kurdo që vendoset për jetët e fëmijëve të tyre. Institucionet arsimore kanë një rol të madh në fuqizimin e fëmijëve në

pjesëmarrje. Strukturave përfaqësuese të fëmijëve në nivele të ndryshme do t'u ofrohet hapësirë veprimi dhe përkrahje nga të rriturit në zhvillimin e kapaciteteve të tyre. Organet vendimmarrëse në të gjithë sektorët e komunës do të ndjekin procedurat e konsultimeve me fëmijë para se të marrin vendime që ndikojnë në jetën e fëmijëve.

5.1 Përcaktimi dhe zbatimi i procedurave të konsultimit me fëmijët me rastin e vendimmarrjes

Do të përcaktohen procedurat për konsultimin e fëmijëve për të gjitha palët në komunë që marrin vendime për fëmijët dhe në përgjithësi për qytetarët e komunës. Këto procedura do të paraqiten përmes një udhëzuesi praktik. Do të monitorohet zbatimi i procedurave të konsultimit me fëmijë nga të gjithë sektorët komunalë me rastet e hartimit të projekteve zhvillimore, strategjive e planeve të veprimit, me rastin e planifikimit të buxhetit, etj.

5.2 Fuqizimi i organeve përfaqësuese të fëmijëve

Këshillat e nxënësve janë organe të nxënësve të parapara me ligj. Ndonëse ato janë të themeluara në të gjitha shkollat, funksionimi i tyre duke përfshirë mënyrën e përzgjedhjes dhe mandatin e angazhimit të tyre është larg prej standardeve të përfaqësimit demokratik. Prandaj, do të nxitet funksionimi i rregullt i organeve përfaqësuese të nxënësve në të gjitha nivelet, duke filluar nga këshillat e nxënësve nëpër klasa e deri te Asambleja Komunale e Fëmijëve. Këto organe duhet të jenë gjithëpërfshirëse në kuptim të përfaqësimit gjinor, gjeografik, etnik, të aftësive, etj. Më tutje, do të zhvillohen kapacitetet e fëmijëve për pjesëmarrje demokratike në jetën shkollore dhe të komunitetit, përmes moduleve të trajnimit për udhëheqje e aktivizim qytetar. Një aspekt qenësor është rregullimi i marrëdhënieve në mes vetë nxënësve. Për këtë arsye do të promovohet ndërmjetësimi në mes moshatarëve si qasje për të adresuar problemet, konfliktet, ngacmimet e dhunën në shkollë, por edhe në lagje. Do të identifikohen fëmijë që mund të angazhohen si ndërmjetësues dhe të trajnohen për aspekte të ndërmjetësimit në mes moshatarëve.

7.6 OBJEKTIVI 6: BASHKËRENDIMI I VEPRIMEVE TË TË GJITHA PALËVE PËRMES PROCESIT TË KOORDINIMIT SI DHE PËRMES VLERËSIMIT DHE RAPORTIMIT PËR GJENDJEN E FËMIJËVE NË KOMUNË

Ne duam që i gjithë procesi i zbatimit të planit të punës të reflektojë qeverisjen e mirë dhe miqësore për fëmijë. Prandaj, është me shumë rëndësi që ky proces të jetë me pronësi të gjerë, ku të gjitha palët do të bashkërendojnë veprimet me qëllimin që të adresohen masat e definuara me planin e punës. Ndërsa, për të siguruar cilësinë na nevojitet zhvillimi i instrumenteve për vlerësimin e ndikimit në fëmijë, dhe hartimi i raporteve për gjendjen e fëmijëve të komunës.

6.1 Vlerësimi i ndikimit në fëmijë dhe raportimi për gjendjen e fëmijëve

I gjithë procesi i qeverisjes miqësore për fëmijë, i bashkërenduar përmes planit të punës ka nevojë t'i nënshtrohet procesit të vlerësimit të ndikimit që ka në fëmijë. Prandaj, fillimisht do të realizohet një studim bazë lidhur me të gjitha aspektet e qeverisjes, që do të shërbejë për monitorim e vlerësim të zbatimit të planit të punës. Pastaj do të bëhet vlerësimi periodik i ndikimit të aspekteve të qeverisjes lokale dhe aspekteve të planit të punës për të drejtat e fëmijës. Raportet nga vlerësimi do të diskutohen në nivel të ekipit komunal dhe po ashtu përfshihen në politikat dhe praktikatat e qeverisjes lokale.

6.2 Koordinimi me palët relevante

Qasja e bashkëpunimit me të gjitha palët, është parim i punës së qeverisjes komunale në përpjekjen për një komunë miqe për fëmijë. Prandaj, do të mbajmë komunikim dhe bashkëpunim të vazhdueshëm me palët e ndryshme si në nivelin lokal (me organizata, grupe joformale, bashkësi lokale, këshilla, etj.), ashtu edhe në nivelin rajonal e qendror (me institucionet qendrore/rajonale që ofrojnë shërbime në nivel komunal, por edhe me vetëqeverisjen qendrore) Kjo do të na ndihmojë që të sigurojmë politika të mira për fëmijët, si dhe të kërkojmë përkrahje shtesë nga niveli qendror për nevojat e fëmijëve të komunës.

6.3 Vlerësimi dhe raportimi

Plani i veprimit do t'i nënshtrohet vlerësimit periodik në baza gjashtëmuajshe, prej nga do të nxirren raportet, të cilat do të shërbejnë për periudhat vijuese të implementimit. Ndërsa në fund të periudhës së zbatimit të planit trevjeçar do të bëhet vlerësimi përfundimtar i zbatimit të këtij plani dhe do të hartohet raporti i cili do të shërbejë si burim për planifikimin e planit të ardhshëm disavjeçar.

8 PLANI I VEPRIMIT

0	Objektiva strategjike
0.0	Masa
	Veprimi
1	Ofrimi i shërbimeve cilësore gjithëpërfshirëse për fëmijët në komunë
1.1	Krijimi i një sistemi informues shumëdimensional për llojet e shërbimeve sociale në komunë
	Bëhet ekzaminimi/evidentimi i shërbimeve ndaj fëmijëve në Komunë
	Zhvillohet katalogu i llojeve të shërbimeve komunale dhe ofruesve të shërbimeve
	Organizohet një fushatë informuese përmes institucioneve publike, mediave lokale dhe ueb-faqes së komunës
1.2	Rritja e fondit për fëmijët në rrethana të jashtëzakonshme
	Identifikohen nevojat për shërbime
	Kontraktohen operatorët ekonomikë për ofrimin e shërbimeve emergjente për fëmijët (si: mallra, ushqim, transport, etj.)

1.4	Zhvillimi i praktikave të prindërimit të mirë dhe disiplinimit pozitiv
	Përshtaten modulet/praktikat ekzistuese të prindërimit të mirë për nevoja të komunitetit.
	Krijohen kapacitetet njerëzore për ofrimin e moduleve të trajnimit (trajnim i trajnerëve), p.sh. psikologët në shkolla, edukatorët, profesionistët shëndetësorë, etj.
	Shpërndahen praktikat e prindërimit të mirë përmes trajnimeve/sesioneve informuese
1.5	Krijimi i mundësive të barabarta për të gjithë fëmijët për ta regjistruar, vijuar dhe përfunduar shkollën
	Bashkëpunohet me zyrën e regjistrimit civil dhe merren informata për të gjithë fëmijët e moshës shkollore të zonës
	Regjistrohen nxënësit duke respektuar rregulloren komunale
	Mirëmbahet baza e të dhënave me të dhëna për nxënësit sipas modelit SMIA-s
	Funksionalizohen Ekipet për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit (EPRBM)
	Bashkëpunohet ngushtë me organizatat që punojnë në fushën e gjithëpërfshirjes në arsim
1.6	Ofrimi i shërbimeve profesionale nëpër shkolla
	Trajnohen mësime dhënëse për identifikimin e hershëm të fëmijëve në nevojë për shërbime profesionale pedagogjike logopedike dhe psikosociale
	Krijohet/funksionalizohet mekanizmi për referimin e fëmijëve në nevojë për shërbime profesionale
	Identifikohen nevojat për mësime dhënëse mbështetës për fëmijët me aftësi të kufizuara
	Punësohen mësime dhënësit mbështetës dhe asistentë për fëmijë me aftësi të kufizuara
1.7	Inspektimi i cilësisë së hapësirave shkollore
	Angazhohen ekipe profesionale për inspektim të gjendjes së shkollave (inspektim të vjetërsisë së objekteve, sanitarisë, hapësirave për lojë e rekreacion, pajisjeve shkollore, etj.)
	Inspektohen objektet shkollore në baza vjetore dhe hartohen raporte

	Ndërmerren masa përmirësuese bazuar në raportet e inspektimit
	Promovohen standardet për shkollat mike për fëmijë
1.8	Krijimi i mekanizmave brenda shkollave për mirëmbajtje të mjediseve shkollore
	Vetëdijesohen nxënësit dhe palët tjera për nevojën e mirëmbajtjes së shkollës
	Hartohet një udhëzues me praktika të mira të mirëmbajtjes së hapësirave shkollore
	Shpërblehen shkollat për mjedis të pastër dhe ekologjikë
1.9	Promovimi shëndetësor përmes informimit, komunikimit dhe edukimit
	Ndërmerret fushatë vetëdijësuese për shëndetin dhe të ushqyerit e foshnjave, fëmijëve dhe adoleshentëve
	Organizohen ligjërata për edukimin shëndetësor dhe reprodutiv për nxënësit e shkollave, përmes sistemit të ligjëratave të profesionistëve shëndetësorë
	Organizohen ligjërata për parandalimin e abuzimit me substanca psikoaktive
1.10	Organizimi i vizitave multidisiplinare shëndetësore për fëmijët në baza periodike
	Zhvillohen kapacitetet e profesionistëve shëndetësorë për kujdes shëndetësor ndaj nënës dhe fëmijës, për këshillim për të ushqyerit e foshnjave dhe fëmijëve të vegjël dhe për përkrahjen e zhvillimit në fëmijërinë e hershme.
	Organizohen vizita shëndetësore në shtëpi për nënat dhe fëmijët
	Zbatohen praktikat efektive të kujdesit perinatal
	Organizohet shërbimi i vizitave sistematike nëpër shtëpi, me komponentin e intervenimit shëndetësor edhe atij edukativ.
	Realizohen kontrollet sistematike shëndetësore nëpër shkolla
1.11	Identifikimi i hershëm i fëmijëve me aftësi të kufizuara
	Përditësohet baza e të dhënave për fëmijët me nevoja të veçanta
	Promovohen shërbimet institucionale dhe të ofruesve të tjerë të shërbimeve për fëmijë me aftësi

	të kufizuara, me fokus në përfitimet e këtyre fëmijëve dhe familjeve të tyre
	Hartohet/përdoret dokumenti (formulari) për deklarimin e prindit për gjendjen shëndetësore të fëmijës, gjatë regjistrimit në shkollë
	Bëhen vlerësime të fëmijëve në nevojë dhe rekomandohen masat që duhet ndërmarrë shkolla (mësimdhënësit, menaxhmenti i shkollës, prindërit)
1.12	Ofrimi i shërbimeve të veçanta për kategoritë e fëmijëve në nevojë
	Subvencionohen organizatat e licencuara që ofrojnë shërbime shumëdimensionale dhe rehabilitim të bazuar në bashkësi, për fëmijët me aftësi të kufizuara
	Identifikohen nevojat dhe sigurohet qasja fizike e fëmijëve me aftësi të kufizuara në hapësira publike
	Ofrohen programe të mbështetjes shtesë për fëmijët nga grupet e cenueshme (komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian, fëmijët në situatë rruge/lëmoshë kërkuesit, fëmijët që punojnë punë të rënda dhe të rrezikshme, fëmijët viktimë e trafikimit, etj.), të tilla si mësimi shtesë përmes qendrave mësimore, përfshirja në aktivitete rekreative të qendrave rinore, sesione këshillimi, etj.
	Avancohet komunikimi ndërmjet palëve kryesore (Qendrës për Punë Sociale, Kujdesit Parësor Shëndetësor, Personelit Arsimor, Policisë, Gjykatës, Organizatave Joqeveritare, etj) për një referim dhe kujdes ndaj fëmijëve në nevojë
2	Zbatimi i programeve të vetëdijesimit dhe avokimit për mirëqenien e fëmijëve
2.1	Ngritja e kapaciteteve të politikëbërësve dhe zyrtarëve komunalë për aspekte të të drejtave të fëmijëve
	Ofrohen trajnimet për politikëbërësit dhe zyrtarët komunalë në fushën e të drejtave dhe mirëqenies së fëmijës
2.2	Organizimi i fushatave vetëdijesuese për të rriturit dhe për fëmijët
	Planifikohen dhe organizohen fushatat vetëdijesuese dhe shpërndahet material promovues për mbrojtjen e fëmijëve dhe të drejtat e tyre
2.3	Mbështetja e organizatave joqeveritare dhe institucioneve të pavarura në avokimin për të drejtat e fëmijës
	Përkrahët puna e organizatave joqeveritare, koalicioneve e rrjeteve që monitorojnë, promovojnë

	dhe mbrojnë të drejtat e fëmijëve
	Mundësohet dhe përkrahet puna e vetë strukturave organizative të fëmijëve dhe të rinjve
2.4	Promovimi i të drejtave të fëmijës përmes mediave
	Ofrohen udhëzues dhe trajnime për zyrën komunale për marrëdhënie me publikun, për sekretariatit e Ekipit dhe mediat e profesionistët e mediave të shkruara dhe elektronike
	Përkrahen mediat që të promovojnë të drejtat e fëmijëve dhe që të paraqesin gjendjen e fëmijëve në mënyrë transparente e reale
	Organizohen forume diskutimi në mes komunës dhe mediave lidhur me standardet për mbrojtjen e identitetit dhe integritetit të fëmijëve
3	Krijimi i hapësirave publike të sigurta dhe miqësore për fëmijët
3.1	Sigurimi i sistemit të trafikut që është i sigurt dhe miqësor për fëmijët
	Hartohen dhe realizohen projekte për lirim të trotuareve dhe vendkalimeve për këmbësorë, vendosjen e shenjave të vendkalimeve, vendosjen e barrierave, sinjalizimi i shtigjeve të biçiklistëve etj.
	Bëhet fushatë informimi me të gjithë pjesëmarrësit në trafik për sigurinë në trafik
3.2	Eliminimi i rreziqeve dhe krijimi i mjedisit ekologjik
	Promovohet linja telefonike për publikun për raportimin e rreziqeve si dhe merren masa për eliminimin e tyre në afat sa më të shkurtër.
	Menaxhohen /sistemohen qentë endacakë
	Merren masa për të parandaluar rreziqet përreth shkollës (personat e paautorizuar, shitja e artikujve të dëmshëm, etj.)
	Rritet sipërfaqja e hapësirave të gjelbra e parqeve në qytet, si dhe pyjeve në pjesën rurale.
4	Zhvillimi i fëmijëve përmes sporteve, lojës dhe rekreacionit
4.1	Promovimi i sportit nëpër shkolla

	Ngritën kapacitetet e përfaqësuesve të shkollave për promovimin e sportit shkollor
	Krijohen/zhvillohen klubet sportive shkollore
	Organizohen gara sportive mes shkollave
4.2	Funksionalizimi i klubeve sportive të kategorive të reja
	Nxitet rekrutimi i fëmijëve djem e vajza nëpër klube sportive
	Mbështetet komunikimi në mes të klubeve, shkollave dhe prindërve
	Organizohen kampe për identifikimin e talenteve në sporte
4.3	Promovimi i artit, kulturës dhe teknologjisë
	Nxitet themelimi/funksionimi i klubeve artistike e kulturore nëpër shkolla
	Organizohen aktivitete të përbashkëta të klubeve artistike e kulturore të shkollave dhe të organizatave të artit e kulturës, si: teatro, ansamble të këngëve e valleve, klube letrare, etj.
	Ofrohen më shumë hapësira nëpër shkolla që fëmijët të zhvillojnë shkathtësitë teknologjike, si: programim, kodim, ueb dizajn, etj.
4.4	Ofrimi i hapësirave joformale për rekreacion
	Inspektohen parqet ekzistuese dhe identifikohen nevojat për hapësira shtesë për lojë
	Intervenohet në adaptimin e hapësirave ekzistuese për lojë dhe në ndërtimin e hapësirave të reja
	Krijohen ekipet e përbashkëta për mirëmbajtjen e hapësirave rekreative
4.5	Angazhimi i fëmijëve në aktivitete të lira dobiprurëse për komunitetin
	Organizohen kampe të natyrës rekreative, edukative, mjedisore, etj., për fëmijët e shkollave dhe organizatave të fëmijëve
	Organizohen vizita e takime në institucione për mbrojtjen e të drejtave të njeriut/fëmijëve
	Angazhohen fëmijët dhe të rinjtë në aktivitete në përfitim të komunitetit (mbjellja e drunjve, ofrimi i ndihmës së parë, evakuimi, siguria në trafik)

5	Sigurimi i pjesëmarrjes së fëmijëve në proceset vendimmarrëse për çështjet që lidhen me jetën e tyre
5.1	Përcaktimi dhe zbatimi i procedurave të konsultimit me fëmijët me rastin e vendimmarrjes
	Hartohet një udhëzues praktik për procedurat e konsultimit me fëmijë që në fazat e hershme të proceseve vendimmarrëse
	Monitorohet zbatimi i procedurave të konsultimit me fëmijë
5.2	Fuqizimi i organeve përfaqësuese të fëmijëve
	Nxitet funksionimi i rregullt i organeve përfaqësuese të nxënësve në të gjitha nivelet
	Trajnohen përfaqësuesit e nxënësve për udhëheqje dhe aktivizim qytetar
	Promovohet ndërmjetësimi në mes moshatarëve si qasje për të adresuar problemet, konfliktet, ngacmimet e dhunën në shkollë
6	Bashkërendimi i veprimeve të të gjitha palëve përmes procesit të koordinimit si dhe përmes vlerësimit dhe raportimit për gjendjen e fëmijëve në komunë
6.1	Vlerësimi i ndikimit në fëmijë dhe raportimi për gjendjen e fëmijëve
	Realizohet një studim bazë lidhur me të gjitha aspektet e qeverisjes që do të shërbejë për monitorim e vlerësim të zbatimi të planit të punës
	Bëhet vlerësimi periodik i ndikimit të aspekteve të qeverisjes lokale dhe aspekteve të planit të punës për të drejtat e fëmijës
	Diskutohen raportet në nivel të ekipit komunal dhe po ashtu përfshihen në politikat dhe praktikat të qeverisjes lokale
6.2	Koordinimi me palët relevante
	Mbahet komunikim e bashkëpunim sipas nevojës me palët e tjera në nivel qendror lokal dhe në nivel të komunitetit
6.3	Vlerësimi dhe raportimi
	Bëhet vlerësimi periodik (çdo 6 muaj) i zbatimit të planit të punës dhe hartohet raporti

9 SHTOJCA: PLANI I DETAJUAR I VEPRIMIT

Plani i detajuar i veprimit (me bartësit, shtrirjen kohore, nevojat buxhetore dhe burimet e financimit) është dhënë si shtojcë në një dokument, Excel.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

DRAFT-RREGULLORE PËR TAKSA, TARIFA DHE NGARKESA KOMUNALE

Klinë, mars 2024

Kuvendi i Komunës së Klinës

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 11, 12.2 shkronja c), dhe nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja a) dhe g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040 publikuar në Gazetën Zyrtare, nr.28/2008, dispozitat e nenit 2,3, 8 dhe 13 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, nr.03/L-049 publikuar në Gazetën Zyrtare nr.27/2008, dispozitat e nenit 10 pika 1 të Statutit të Komunës së Klinës nr.01-110-1232/2010 i miratuar më dt. 31.03.2010, dispozitat e Rregullores (MAPL) nr.02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës, në seancën e rregullt të Kuvendit të Komunës së Klinës të ___ me radhë të mbajtur më datë ___/___/2024, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR TAKSA, TARIFA DHE NGARKESA KOMUNALE

KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e aktiviteteve të cilat i nënshtrohen taksës komunale në Komunën e Klinës (këtu e tutje “Komuna”), lartësinë e taksave komunale, përcaktimin e kategorive të liruara nga kjo taksë dhe përcaktimin e kundërvajtjeve dhe sanksioneve kundërvajtëse për shkeljet e dispozitave të kësaj Rregulloreje.

Neni 2 Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj Rregulloreje janë të obligueshme për të gjithë personat fizikë dhe juridikë që nëpërmjet ndonjë aktiviteti të zhvilluar obligohen të paguajnë taksë komunale të përcaktuar me këtë Rregullore si dhe për të gjitha njësitë e Komunës që zbatojnë dispozitat e kësaj Rregulloreje.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdoruar në këtë Rregullore kanë këto kuptime:

1.1. **Taksë komunale** – nënkupton shumën fikse dhe e pakthyeshme e pagesës sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje, që paguhet nga personat juridikë dhe fizikë autoriteteve të Komunës në mënyrën e paraparë në këtë Rregullore, në emër të:

1.1.1. Lëshimit të certifikatave dhe dokumenteve tjera zyrtare të lëshuara nga Komuna;

1.1.2. Shërbimeve administrative të pranuar nga Komuna;

1.1.3. Ushtrimit të veprimtarisë afariste në territorin e Komunës;

1.1.4. Pronësisë së mjeteve motorike në territorin e Komunës;

1.1.5. Ndërtimit, rrënimit të objekteve dhe ndërhyrjeve në infrastrukturë komunale në territorin e Komunës; dhe

1.1.6. Shfrytëzimit të objekteve, hapësirës apo të mirave tjera publike në territorin e Komunës.

1.2. **Taksa qendrore** – nënkupton taksat që përcaktohen nga Qeveria e Republikës së Kosovës të cilat mbliken nga Komuna;

1.3. **Vit fiskal** - nënkupton periudhën nga data një (1) janar deri më datën tridhjetë e një (31) janar të të njëjtit vit.

1.4. **Gjobë** – nënkupton sanksionin kundërvajtës që i shqiptohet personave juridikë dhe fizikë për shkelje të dispozitave të kësaj Rregulloreje.

1.5. **Person** – nënkupton personin fizik dhe juridik;

1.6. **Person fizik** – nënkupton personin fizik jo afarist që nuk ka të regjistruar aktivitet biznesi; dhe personi fizik afarist që ka të regjistruar biznes në bazë të legjislacionit në fuqi dhe që zhvillon aktivitet të rregullt afarist.

1.7. **Person juridik** – nënkupton një shoqëri ose një organizatë tjetër biznesi që ka statusin e një personi juridik sipas legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare dhe çdo legjislacion tjetër të aplikueshëm në Kosovë.

1.8. **Pano reklamuese** – nënkupton tabelën apo shenjën reklamuese me qëllim të reklamimit të mallrave apo shërbimeve, i vendosur në një objekt statik apo lëvizës; dhe

1.9. **Shoqëri Tregtare** – nënkupton termin e përgjithshëm që përfshin çfarëdo lloji të shoqërisë tregtare të themeluar në Kosovë sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare apo ndonjë ligji tjetër, duke përfshirë bizneset individuale, ortakëritë e përgjithshme, ortakëritë e kufizuara, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare.

KAPITULLI II KORNIZAT E PËRGJITHSHME TË TAKSAVE KOMUNALE

Neni 4

Parimet e përgjithshme të taksave komunale në Komunë

1. Të gjitha taksat komunale përcaktohen me këtë Rregullore dhe me ndonjë Rregullore tjetër komunale.

2. Të gjitha taksat komunale përcaktohen duke marrë parasysh parimin e jo diskriminimit dhe të proporcionalitetit, sipas dispozitave ligjore në fuqi.
3. Taksat komunale që rezultojnë si pasojë e ndonjë veprimi apo shërbimi të kryer nga organet e Komunës, bazohen në koston e atij veprimi që i është shkaktuar Komunës.
4. Asnjë taksë komunale që nuk është e përcaktuar me këtë Rregullore apo në ndonjë Rregullore tjetër komunale nuk mund të kërkohej që të paguhet.

Neni 5

Pagesa e taksave komunale

1. Të gjitha pagesat e taksave komunale që duhet të kryhen sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje, bëhen sipas shumave të përcaktuara në këtë Rregullore dhe paguhen në valutën euro (€).
2. Të gjitha pagesat mbi dhjetë (10 €) euro sipas kësaj Rregulloreje bëhen nëpërmjet bankave apo institucioneve financiare të licencuara, nëpërmjet një urdhërpagese të pranuar nga zyrtari përkatës komunal, në xhirollogarinë e Komunës të përcaktuar vendimin e Kryetarit të Komunës.
3. Të gjitha pagesat deri në dhjetë (10 €) euro sipas kësaj Rregulloreje bëhen pranë institucioneve përkatëse komunale.
4. Për pagesat e realizuara sipas paragrafit tre (3) të këtij neni, Komuna lëshon vërtetim përkatës.
5. Të gjitha pagesat e realizuara sipas paragrafit tre (3) të këtij neni dhe pagesat e bëra nëpërmjet kioskave elektronike (e-kiosku), deponohen në xhirollogarinë e Komunës deri në fund të ditës së pranimit.

Neni 6

Lirimet nga taksat komunale

1. Të gjitha kategoritë e liruar nga pagesa e taksave komunale sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje, përcaktohen me këtë Rregullore.
2. Për çdo lloj lirimi nga taksat komunale të përcaktuara me këtë Rregullore, personat që përfitojnë nga ky lirim ofrojnë dokumentacionin përkatës që dëshmon përkatësinë e tyre për të përfituar nga lirimet.
3. Për çdo lloj lirimi nga taksat komunale të përcaktuara me këtë Rregullore, zyrtari përgjegjës i Komunës ia bashkëngjit lëndës shkresën me bazën ligjore për lirim nga pagesa.
4. Nëse ndonjë procedurë ku kërkohej pagesa e taksave komunale është filluar me kërkesë të më shumë se një personi, ku jo të gjithë janë të liruar nga pagesa e taksave komunale, atëherë taksa komunale paguhet nga ai person i cili nuk është i liruar nga pagesa.

5. Dokumentacioni që lëshohet për përdorim në botën e jashtme nuk lirohet nga pagesa e ngarkesave, tarifave dhe taksave komunale nga kjo rregullore.

KAPITULLI III

DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 7

Dënimet mandatore, kundërvajtjet administrative, gjobot dhe masat tjera mbrojtëse

1. Disa nga veprimet në kundërshtim me ligjin dhe këtë rregullore, konsiderohen kundërvajtje, kjo në bazë të bazë të parimit ligjor-legalitetit: se askush nuk mund të jetë përgjegjës për kundërvajtje dhe as që mund t'i shqiptohet dënim përkatës nëse më parë vepra e kryer nuk ka qenë me ligj apo me akt tjetër normativ e paraparë si kundërvajtje.
2. Varësisht nga kundërvajtja e kryer të pandehurit do t'i shqiptohen ndëshkimet adekuate kundërvajtëse sipas Ligjit për Kundërvajtje.
3. Lidhur me kundërvajtjet e kryera, inspektori kompetent komunal apo organi tjetër i autorizuar komunal mund të iniciojë procedurën përkatëse kundërvajtëse, me paraqitjen e kërkesës përkatëse tek gjykata kompetente që shqyrton çështjet kundërvajtëse apo gjykata tjetër me kompetencë reale dhe territoriale.
4. Varësisht nga rastet konkrete subjekteve afariste dhe personave të tjerë mund t'iu shqiptohen ndëshkimet përkatëse kundërvajtëse, duke përfshirë ndëshkimet kundërvajtëse administrative dhe gjobot si dhe masat tjera mbrojtëse për shkeljen e dispozitave të ligjit dhe kësaj rregulloreje.

Neni 8

Dënimet mandatore

1. Dënimet mandatore, përkatësisht gjobot janë masa ndëshkimore, të cilat mund t'i shqiptojë inspektori kompetent komunal apo organi tjetër i autorizuar, varësisht nga rasti të cilat iu shqiptohen të gjithë obliguesve të ngarkesave, tarifave dhe taksës e të cilët nuk i përmbushin obligimet përkatëse rreth pagesës adekuate të përcaktuar sipas kësaj rregulloreje.
2. Për eksploatim të egër (të pa ligjshëm) të zhavorrit, eksploatuesi jolegal gjobitet prej 20 € deri në 30 € për Im^3 të zhavorrit të eksploatuar, varësisht nga recidivizmi.
3. Nëse personi fizik apo juridik haset nga inspekcioni duke eksploatuar pa leje apo eksportuar zhavorr apo rërë dhe i cili nuk posedon dokumentacionin përkatës, i shqiptohet dënimi mandator sipas paragrafit 2 të këtij neni ashtu që zhavorri-rëra i konfiskohet. Ndërkaq nëse personi i tillë nuk e paguan dënimin mandator, po ashtu, zhavorri-rëra i konfiskohet dhe lënda më tej me fletëparaqitje përkatëse i dërgohet Gjykatës Themelore kompetente për vendosje të mëtejme meritore gjyqësore.

4. Ndotësit e ujërave të lumenjve, subjektet juridike ose fizike gjobiten në shumën prej 20 € deri në 25 €, varësisht nga masa e ndotjes dhe recidivizmi.
5. Për shfrytëzimin e panevojshëm dhe ilegal të ujit të pijshëm që përdoret për qëllime të pastrimit, rrugëve, trotuareve, oborreve, për ujitje të kopshteve, fushave, pemëve etj., përcaktohet gjoba në lartësi prej 25€ .
6. Lartësia e gjobës është dyfishi i tarifës dhe ngarkesës së përcaktuar për kryerjen e shërbimit përkatës, nëse ndryshe nuk përcaktohet me ligjin e veçantë.
7. Të gjitha limitet e dënimeve mandatore apo gjobave nga kjo dispozitë zbatohen drejtpërsëdrejti, të ndryshuara nga të lartëcekurat, nëse ato janë të përcaktuara me ligjet e veçanta dhe aktet e tjera të veçanta të pushtetit qendror.
8. Afati për pagesën e të gjitha gjobave apo dënimeve të shqiptuara mandatore nga inspeksioni është 8 (tetë) ditë nga dita e shqiptimit apo në afatin tjetër ligjor të gjykatës nga dita e pranimi të vendimit gjyqësor.
9. Në rast se ndëshkimet apo dënimet nuk paguhën në afatin e paraparë, nga inspektori kompetent inicohet procedura përkatëse pranë gjykatës kompetente.

Neni 9

Dënimet tjera

1. Vazhdimi i ripërtëritjes së lejeve dhe licencave mund të jepet deri më 28 shkurt dhe atë me dënim 20 % në detyrimet dhe ngarkesat e caktuara për leje dhe licenca për veprimtari të cilën e zhvillon.
2. Licencat apo lejet e dërguara për vazhdim pas 28 shkurtit duhet të ngarkohen edhe me dënim shtesë për 5 % në muaj.
3. Shuma e përgjithshme e dënimit për vazhdimin e lejes, licencës nuk mund të kalojë vlerën e dyfishit të tarifës dhe ngarkesës të përcaktuar për kryerjen e atij shërbimi.

Neni 10

Mosrespektimi i afateve të pagesave

1. Në rast të mosrespektimit të afateve, direktivave dhe standardeve të paraqitura të lejeve të veprimtarisë do të zbatohen dispozitat ndëshkuese të ligjeve të veçanta që rregullojnë veprimtaritë e veçanta.
2. Përjashtim nga zbatimi i 3 alineve të kësaj dispozite bën zbatimi i drejtpërdrejtë i ligjeve dhe akteve të veçanta të pushtetit qendror që rregullojnë dënimet përkatëse.
3. Shqiptimi dhe inkasimi i gjobave në trafik si dhe gjobat tjera për shkeljen e rregulloreve komunale bëhet në pajtim me nenin 18 dhe 19 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal.

Neni 11

Ndëshkimet kundërvajtëse

1. Ndëshkimet kundërvajtëse-gjobat i shqipton gjykata kompetente që shqyrton çështjet e kundërvajtjeve, për rastet e shkeljeve të dispozitave përkatëse ligjore të ligjeve të veçanta, që ndërlidhen me tarifa, ngarkesa dhe gjoba, si dhe për shkeljen e dispozitave që ndërlidhen me dispozitat e Rregullores për Tarifat, Ngarkesat dhe Gjobat komunale, krejt këtë mbi bazë të Ligjit për Kundërvajtjet.
2. Nëse shkelen dispozitat e Ligjit për Ndërtimin, shkeljet e tilla përcaktohen në nenin 70 të tij, apo ndryshimet dhe plotësimet e ardhshme. Ndërkaq, nëse shkelen rregullat e tregtisë së brendshme, që ndërlidhen me dispozitat e shitjes së mallrave në ambient të hapur të subjekteve të pa regjistruara, shqiptohen gjobat sipas nenit 12 të Ligjit për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Tregtinë e Brendshme nr.04/L-005.

Neni 12

Masat mbrojtëse

1. Për mosrespektimin e sigurisë publike, pastaj mosrespektimin e standardeve higjienike, si dhe të shkeljes së dispozitave të kësaj rregulloreje dhe të ligjeve të tjera që përligjojnë çështjet e ngarkesave, tarifave dhe taksave komunale, mund të merren edhe masa mbrojtëse ndaj qytetarëve, personave fizikë dhe personave juridikë që ushtrojnë veprimtaritë përkatëse, krejt kjo në kuptim me ligjet përkatëse.
2. Komuna do të lëshojë një urdhër ndalimi të ushtrimit të veprimtarisë dhe do të bëjë mbylljen e përkohshme të veprimtarive (thertore, mishtore, shtëpi, ambulancë, dyqan ushqimor dhe të gjitha veprimtaritë tjera të kësaj natyre që paraqesin rrezik për shëndetin publik dhe sigurinë standarde) e që janë nën inspektim dhe deri sa testet e nevojshme laboratorike si dhe deri sa të konstatohet se nuk ka rrezik për shëndetin publik.
3. Mosrespektimi i higjienës, shëndetit publik dhe siguria standarde do të jetë arsye dënimi çdo herë dhe minimumi i dënimit do të jetë prej 100 € deri në maksimumin e dënimit prej 200 € varësisht nga shkalla e mosrespektimit.
4. Përfshirje nga zbatimi i alineve të mëparshme të kësaj dispozite bënë zbatimi i drejtëpërdrejtë i ligjeve të veçanta dhe akteve tjera të veçanta të pushtetit qendror të cilat rregullojnë çështjen e ndëshkimeve kundërvajtëse dhe masave mbrojtëse.

Neni 13

Ankesat dhe mbrojtja juridike

1. Pala mund të ushtrojë ankesë ndaj vendimeve të lëshuara nga organet komunale kompetente, lidhur me tarifën dhe ngarkesat komunale sipas kësaj rregulloreje, krejt këtë në afatin e paraparë ligjor dhe në pajtim me Statutin e Komunës.
2. Procedura e ankesës duhet të jetë në përputhje me dispozitën e nenit 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 si dhe dispozitat përkatëse të Ligjit për Procedurën Administrative nr. 02/L-28.

KAPITULLI IV
DREJTORIA E ADMINISTRATËS
TAKSA KOMUNALE PËR LËSHIMIN E CERTIFIKATAVE DHE DOKUMENTEVE
ZYRTARE

Neni 14

Lartësia dhe pagesa e taksës për lëshimin e certifikatave dhe dokumenteve zyrtare

1. Të gjithë personat që pajisen me certifikata zyrtare dhe dokumente tjera zyrtare nga Komuna, paguajnë taksë komunale, si në vijim:

Nr. Rendor, tarifa, Përshkrime		Vlera e taksës
1.1.	Certifikata e lindjes	1 €
1.2.	Ekstrakt i lindjes	1 €
1.3.	Certifikata të martesës	1 €
1.4.	Certifikata e vdekjes	1 €
1.5.	Certifikata e shtetësisë	1 €
1.6.	Certifikata e vendbanimit	1 €
1.7.	Certifikata e bashkësisë familjare	2 €
1.8.	Certifikata e statusit martesor	2 €
1.9.	Vërtetim nga arkiva	2 €
1.10	Certifikata për lajmërim ç'lajmërim të vendbanimit	2 €
1.11.	Aktivdekje	3 €
1.12.	Vërtetimi që nuk është i regjistruar në R.TH.L	2 €
1.13,	Procesverbal mbi pranimin e atësisë\amësisë	2 €
1.14.	Deklarata me dy dëshmitarë	2 €
1.15.	Deklarata me kërkesë të autoriteteve të huaja	5 €
1.16.	Regjistrimi i martesave në mes të shtetasve të Kosovës	10 €
1.17.	Regjistrimi i martesave në mes të shtetasve të huaj	30 €
1.18.	Përkthimi gjatë Ceremonisë së martesës	30 €

1.19.	Aktvendim për regjistrim të mëvonshëm në LAL	5 €
1.20.	Aktvendim për korrigjim të emrit dhe mbiemrit	5 €
1.21.	Aktvendim për ndërrim të emrit dhe mbiemrit	20 €
1.22.	Dokumente për kalimin e kufirit vendosja e fotos në certifikatë	2 €
1.23.	Konfirmim dhe vërtetime tjera të Gjendjes Civile	3 €
1.24.	Konfirmim i nacionalitetit apo identitetit	5 €
1.25.	Ndërrimi i mbiemrit pas shkurorëzimit të martesës	10 €
1.26.	Vërtetim për lirim nga shtetësia në Z.GJ.C	5 €
1.27.	Regjistrimi i mëvonshëm i lindjes sipas ligjit të Gj.C. neni 63	25€
1.28.	Regjistrimi i mëvonshëm i vdekjes sipas ligjit të Gj.C. neni 63	55€
1.29.	Varrimi pa leje i organit kompetent	20 €
1.30.	Procedura e kurorëzimit në objekt të komunës, jashtë orarit të punës	20 €
1.31.	Procedura e kurorëzimit jashtë objektit të komunës, gjatë orarit të punës	40 €
1.32.	Procedura e kurorëzimit jashtë objektit të komunës dhe jashtë orarit të punës	50 €
1.33.	Vërtetim që personi nuk është banor i komunës	1 €
1.34.	Ndryshimi i emrit personal	5 €
1.35.	Korrigjimi emrit personal (germëzimi)	3 €
1.36.	Vërtetimi që personi nuk është banor i komunës	1 €
1.37.	Vërtetimi që personi nuk është në marrëdhënie pune	1 €
1.38.	Vërtetimi për gjendjen ekonomike	1 €
1.39.	Vërtetim për afërsinë familjare	1 €
1.40.	Vërtetim mbi marrëdhëniet familjare	1 €

2. Pagesa sipas paragrafit 1 të këtij neni bëhet para pranimit të certifikatës apo dokumenteve zyrtare.

2.1. Pa dëshmi të pagesës nuk mund të dorëzohet kërkesa apo të merret certifikata apo dokumenti zyrtar.

3. Për pagesat e bëra sipas paragrafit 1 të këtij neni, Komuna lëshon dëshmi përkatëse dhe kjo dëshmi është e vlefshme brenda gjithë vitit fiskal, në rast se kërkesa për marrje të certifikatave dhe dokumenteve zyrtare nuk mund të dorëzohet pas pagesës së taksës.

Neni 15
Lartësia dhe pagesa e taksave komunale administrative

1. Të gjithë personat që pranojnë shërbime të caktuara komunale nga Komuna të paraparë në këtë nen, paguajnë taksë komunale administrative, si në vijim:

1.1.	Parashtresat dhe propozimet	0,0.€
2.	Certifikata për shtesa fëmimore	5 €
3.	Vendqëndrimi	5 €
4.	Kërkesë për të gjitha veprimet administrative	1 €
5.	Vendime apo Aktvendime	2 €
6.	Pëlqimi	1.5 €
7.	Referencat për operatorët ekonomikë	5 €
8.	Certifikatat për gjendjen ekonomike	1.5 €
9.	Vërtetimi i përshkrimit nga Libri	5 €
10.	Vërtetimi i origjinalit për një faqe, formati A-4	1 €
11.	Vërtetimi i origjinalit për një faqe, formati A-3	1 €
12.	Vërtetimi i dorëshkrimit	1 €
13.	Certifikata mbi mjetet për jetesë, mbajtja e prindërve për një person	5 €
14.	Certifikata mbi mjetet për jetesë, mbajtja e prindërve për dy prindërit	10 €
15.	Vërtetim i deklaratës së dëshmitarëve	1 €
16.	Kërkesa për shpenzimet e varrimit	1 €
17.	Përpilimi i garancionit për ardhjen e mysafirëve	5 €
18.	Vërtetimi dhe dokumentet tjera zyrtare	1 €
19.	Certifikata që është në jetë, që vijnë nga bota e jashtme	5 €

2. Pagesa sipas paragrafit 1 të këtij neni bëhet para pranimit të shërbimit komunal dhe pa dëshmi të pagesës nuk ofrohet shërbimi.

3. Kërkesat në emër të Këshillave (kryetarëve) të Bashkësive Lokale, fshatrave apo lagjeve urbane lirohen nga pagesa e taksës administrative nga nënparagrafi 1.1. i nenit 10.

Neni 16

Detyrimi lidhur me të dhënat

1. Të gjithë personat që kërkojnë të pajisen me certifikatat e parapara nga neni 14 dhe 15 i kësaj Rregulloreje, duhet të ofrojnë të dhënat lidhur me regjistrin civil me kohë dhe t'i përditësojnë ato brenda afatit të përcaktuar ligjor.
2. Të gjithë personat që kërkojnë të pajisen me vërtetimet e parapara nga neni 14 dhe 15 i kësaj Rregulloreje, duhet të ofrojnë informata të sakta lidhur me gjendjen përkatëse për të cilën pajisen me vërtetim.

KAPITULLI V

TAKSAT KOMUNALE ADMINISTRATIVE

Neni 17

Lirimet nga pagesa e taksës për lëshimin e certifikatave dhe dokumenteve zyrtare

1. Nga pagesa e taksës për lëshimin e certifikatave dhe dokumenteve zyrtare janë të liruar kategoritë si në vijim:
 - 1.1. Veteranët e luftës – bashkëshortja dhe fëmijët deri në moshën 18 vjeçare (dëshmi kartela valide);
 - 1.2. Invalidët e luftës së UÇK-së – bashkëshortja dhe fëmijët deri në moshën 18 vjeçare (dëshmi kartela valide);
 - 1.3. Familjarët e dëshmorëve të luftës – bashkëshortja dhe fëmijët deri në moshën 18 vjeçare (dëshmi kartela valide);
 - 1.4. Familjarët e të zhdukurve të luftës - bashkëshortja dhe fëmijët deri në moshën 18 vjeçare (dëshmi kartela valide);
 - 1.5. Familjarët e viktimave civile të luftës (martirëve) - bashkëshortja dhe fëmijët deri në moshën 18 vjeçare (dëshmi kartela valide);
 - 1.6. Viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës;
 - 1.7. Personat e verbër;
 - 1.8. Personat paraplegjik dhe tetraplegjik (me aftësi të kufizuara); dhe
 - 1.9. Përfituesit e skemave sociale (dëshmi kartoni i socialit- valid).
2. Lirimi nga alineja e mësipërme bëhet vetëm sa i përket nxjerrjes dhe rregullimit të dokumentacionit që ka të bëjë me çështjet e invaliditetit dhe pensioneve përkatëse nga kategoria të cilës i takon parashtruesi i kërkesës apo anëtar i familjes së ngushtë të tij, si dhe dokumentacionit që ka të bëjë me shkollimin e obliguar prej atij parafillor dhe deri në shkallën IX (nëntë) të përgatitjes shkollore apo shkallës tjetër që lejohet sipas ligjit përkatës.

3. Dokumentacioni që lëshohet për përdorim në botën e jashtme nuk lirohet nga pagesa e ngarkesave, tarifave dhe taksave komunale nga kjo rregullore.

KAPITULLI VI

DREJTORIA E FINANCAVE, EKONOMISË DHE ZHVILLIMIT

TAKSA KOMUNALE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË AFARISTE

Neni 18

Lartësia dhe pagesa e taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste

1. Çdo shoqëri tregtare e regjistruar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK) që ndodhet brenda Komunës, paguan taksë vjetore komunale në emër të ushtrimit të veprimtarisë afariste profesionale, për aktivitet ekonomike të zhvilluar si në vijim:

2. kategoria A:

	Kategoria A	
2.1.	Bankat	400 €
2.2.	Hotelet	400 €
2.3.	htëpitë	400 €
2.4.	Kompanitë e sigurimeve	400 €
2.5.	Minierat	400 €
2.6.	Përfaqësitë e ndërmarrjeve të jashtme	400 €
2.7.	Industria mekanike, metarulgjike dhe kimike	400 €
2.8.	PTK, KEK-u, kompanitë e rrjetit kabllorik dhe ajror të interneteve si dhe degët e tyre,	400 €
2.9.	Qendrat tregtare	400 €

3. Kategoria B

	Kategoria B	320 €
3.1.	Motelet	320 €
3.2.	Gurëthyesit	320 €
3.3.	Depot me shumicë	320 €
3.4.	Ndërmarrjet tregtare me shumicë	320 €
3.5.	Ndërmerrjet publike (ndërmarrjet e ujit dhe mbeturinave)	320 €
3.6.	Shpedicionet	320 €
3.7.	Ndërmarrjet prodhuese të llaqeve, ngjitësit	320 €
3.8.	Restorantet-pishina	320 €
3.9.	Veprimtaria për thyerje të gurit-dhëniën e formës dhe finicionin	320 €
3.10.	Pompat e karburanteve në qytetin e Klinës	240 €
3.11.	Pompat e karburanteve në dalje të qytetit të Klinës në drejtim të Skenderajt	240 €
3.12.	Pompat e karburanteve në dalje të qytetit të Klinës në drejtim të Istogut	240 €
3.13.	Pompat e karburanteve prej qytetit të Klinës deri të magjstralja Pejë-Prishtinë-Gjakovë	320 €

3.14.	Pompat e karburanteve në viset rurale	150 €
-------	---------------------------------------	-------

4. Kategoria C

	Kategoria C	
4.1.	Veprimtaria e shitjes së tepihëve dhe perdeve	160 €
4.2.	Agjencitë turistike	160 €
4.3.	Ndërmarrjet projektuese	160 €
4.4.	Ndërmarrjet botuese dhe grafike	160 €
4.5.	Vetëshërbimet e mëdha, supermarketet, shtëpitë e mallrave	160 €
4.6.	Ndërmarrjet ndërtimore	160 €
4.7.	Poliklinikat shëndetësore	160 €
4.8.	Fabrikat e përpunimit të miellit	160 €
4.9.	Ndërmarrjet turistike	160 €
4.10.	Ndërmarrjet që merren me përpunimin e drurit dhe plastikës (dyer, dritare, panove reklamuese)	160 €
4.11.	Ndërmarrjet për servisimin e automjeteve	160 €
4.12.	Restorantet	160 €
4.13.	Tregtia me pakicë e kompjuterëve dhe pajisjeve të TI	160 €
4.14.	Tregtia e pajisjeve sanitare	160 €
4.15.	Tregtia me pakicë e mobileve	160 €
4.16.	Veprimtaritë për dhënien e automobilave me qira	160 €
4.17.	Tregtia me pakicë e teknikës së bardhë	160 €
4.18.	Tregtia me pakicë e artikujve të imtë e ngjyrave, llaqeve dhe materialeve të tjera të sanitarisë së ujit dhe të rrymës	160 €

5. Kategoria D

	Kategoria D	100 €
5.1.	Barnatoret bujqësore	100 €
	Barnatoret shëndetësore	100 €
	Dyqanet në qendër të qytetit (Zona e parë),	100 €
	Butikët	100 €
	Lokalet ushqimore, furrat e bukës	100 €
	Argjendaritë	100 €
	Mishshitësit	100 €
	Auto-transportuesit	100 €
	Filialet e agjencive turistike dhe njësitë e ndërmarrjeve turistike	100 €
	Auto-shkollat	100 €
	Bujtinat	100 €
	Tregtia me pakicë e këpucëve dhe artikujve të tjerë të lëkurës	100 €

6. Kategoria E

	Kategoria E	
6.1.	Rrobaqepësit	80 €
6.2.	Salduesit	80 €

6.3.	Floktaret, berberët	80 €
6.4.	Fotografët	80 €
6.5.	Orëtarët	80 €
6.6.	Internet-kafetë, video-klubet, RTV mekanikët, radiot private, dyqanet në periferi (Zona II)	80 €
6.7.	Kombibusët	80 €
6.8.	Auto-parkingjet	80 €
6.9.	Gjellëtoreset, qebaptoreset, çajtoreset	80 €
6.10.	Autolarjet	80 €
6.11.	Tregtia me pakicë të mjeteve për traktorë dhe mjeteve tjera bujqësore, veprimtaritë e veterinars	80 €
6.12.	Bilardot	80 €
6.13.	Fotokopjet	80 €
6.14.	Servisimi i telefonave apo kompjuterëve	80 €

7. Kategoria F

	Kategoria F	
7.1.	Kioskat në qytet (Zona e parë dhe e dytë)	40 €
7.2.	Dyqanet në zonat rurale që nuk kanë qasje në rrugët regjionale	40 €
7.3.	Veprimtaritë e imëta të biznesit dhe auto-taksitë	40 €
7.4.	Veprimtaria për shitjen e kurorave, funeraleve dhe luleve	40 €
7.5.	Fitneset, veprimtaritë e ndryshme sportive	40 €
7.6.	Shërbimet postare-telefonike	40 €
7.7.	Shtypshkronja dhe shtypshkrime tjera	40 €

Neni 19

Pagesa e taksave, tarifave dhe ngarkesave komunale

1. Taksat tarifore vjetore sipas kategorive të veprimtarive paguhen lidhur me ushtrimin e veprimtarive afariste përkatëse.
2. Subjektet afariste të cilat veprimtarinë e tyre e zhvillojnë më tepër se në një lokal jashtë selisë paguajnë 50 % të taksës së përcaktuar të secilit lokal veç e veç.
3. Taksa për shërbime administrative me rastin e regjistrimit të bizneseve nuk paguhet. Nëse në ndërkohë këto veprime rregullohen me udhëzim të veçantë nga ministria kompetente, vlejnë drejtpërsëdrejti dispozitat e Udhëzimit të veçantë administrativ, (neni 8 i Ligjit nr.04/L-006 për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Shoqëritë Tregtare).
4. Bizneset dhe veprimtaritë e reja që regjistrohen për herë të parë, lidhur me ushtrimin e veprimtarive përkatëse, lirohen nga pagesa e ngarkesave, taksave tarifore në kohëzgjatje prej 18 muajve nga data e regjistrimit fillestar.
5. Ndërmarrjet prodhuese lirohen nga taksa për shërbime për 5 vitet e para të regjistrimit.

6. Afati i ushtrimit të ankesave ndaj aktvendimeve të këtyre taksave caktohet prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit në përputhshmeri me Ligjin mbi Procedurën e Përgjithëshme Administrative.
7. Si prova formale Drejtoria përkatëse duhet të pranojë vërtetimin e shlyerjes së biznesit.

Neni 20

Ushtrimi i veprimtarive intelektuale private dhe taksat tarifore vjetore

1. Për ushtrimin e veprimtarive intelektuale profesionale paguhet taksa tarifore vjetore sipas kategorive përkatëse.
2. Ushtrimi i veprimtarive intelektuale profesionale bëhet sipas standardeve të vërtetuara dhe dëshmive kualifikuese dhe përgatitjes profesionale të lëshuara dhe të legalizuara nga organet kompetente shtetërore.
3. Tarifat vjetore janë renditur sipas llojeve të veprimtarive private profesionale:

3.1.	Shkolla private	120 €
3.2.	Avokatët	120 €
3.3.	Stomatologët	120 €
3.4.	Mjekët e specializuar	160 €
3.5.	Mjeku i praktikës së përgjithshme	80 €
3.6.	Këmbimoret e valutave	120 €
3.7.	Kontrollimi teknik i automjeteve	120 €
3.8.	Zyret projektuese	120 €
3.9.	Kontabilistët	100 €
3.10.	Auditorët	100 €
3.11.	Përkthyesit	80 €
3.12.	Veprimtaria e pavarur veterinare	80 €
3.13.	Tregtia me pakicë e videove dhe CD	80 €
3.14.	Këngëtarët(live)	80 €
3.15.	Kurset profesionale	80 €
3.16.	Motrat medicinale	40 €
3.17.	Këngëtarët (Dj)	40 €
3.18.	Veprimtaritë tjera	80 €
3.19.	Noterët	120 €
3.20.	Përmbaruesit privat	120 €
3.21.	Ueb -portalet	150 €
3.22.	Aktivitetet e programimit dhe transmetimit televiziv	200 €

4. Komuna i dërgon faturat për pagesën e taksës për ushtrimin e veprimtarisë afariste shoqërive tregtare më së largu deri më tridhjetenjë (31) mars të vitit aktual. Nëse komuna nuk ka arritur të dorëzojë faturën brenda këtij afati, obligohen shoqëritë tregtare ta kërkojnë faturën nga Komuna.

5. Shoqëritë tregtare e paguajnë taksën vjetore për ushtrimin e veprimtarisë afariste deri më pesëmbëdhjetë (15) dhjetor të vitit aktual fiskal.

6. Taksa komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste përcaktohet në bazë të aktivitetit kryesor të regjistruar në ARBK.

Neni 21

Pagesa e pjesshme e taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste

1. Në qoftë se shoqëria tregtare është shuar gjatë vitit fiskal, pagesën e taksës komunale e bën si në vijim:

1.1. Nëse shoqëria tregtare është shuar nga data një (1) janar deri më datën tridhjetenjë (31) mars të vitit fiskal, paguan tridhjetë (30 %) për qind të vlerës së taksës;

1.2. Nëse shoqëria tregtare është shuar nga data (31) mars deri më datën tridhjetenjë (31) gusht të vitit fiskal, paguan shtatëdhjetë (70 %) për qind të vlerës së taksës; dhe

1.3. Nëse shoqëria tregtare është shuar nga data (31) gusht deri në datën tridhjetë (30) nëntor të vitit fiskal, paguan nëntëdhjetë (90 %) për qind të vlerës së taksës; dhe

1.4. Nëse shoqëria tregtare është shuar pas datës tridhjetë (30) nëntor të vitit fiskal, paguan taksën e plotë.

2. Shoqëritë tregtare të regjistruara në territorin e Komunës që kryejnë veprimtari në dy (2) apo më shumë njësi, për çdo njësi tjetër paguajnë vlerën prej pesëdhjetë (50%) për qind të taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste.

3. Shoqëritë tregtare që gjatë vitit fiskal kanë qenë pasive dhe nuk kanë ushtruar veprimtari, paguajnë pesëdhjetë (50%) për qind të taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste.

4. Me qëllim të zbatimit të paragrafëve 1 deri në 3 të këtij neni, përfaqësuesit e shoqërive tregtare duhet t'i ofrojnë Komunës dëshmi përkatëse Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) dhe/apo nga institucionet tjera përkatëse.

5. Shoqëritë tregtare që janë të regjistruara jashtë territorit të Komunës, për çdo njësi që vepron në territorin e Komunës paguajnë vlerën e plotë të taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste.

Neni 22

Të hyrat tjera vetanake komunale

1. Të hyrat tjera vetanake të autorizuar në bazë të kësaj Rregulloreje nuk janë gjithëpërfshirëse. Komuna mund të vjelë dhe mbledhë edhe të hyra të tjera përmes tarifave dhe taksave përkatëse komunale, të cilat mund të lejohen me ndonjë ligj tjetër apo edhe në bazë të marrëveshjes me autoritetet qendrore.

Neni 23

Lirimet nga taksa komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste

1. Çdo shoqëri tregtare në vitin e parë të themelimit/regjistrimit të saj, pa marrë parasysh datën e regjistrimit/themelimit, lirohet nga pagesa e taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste.
2. Nga pagesat e taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste janë të liruar kategoritë si në vijim:
 - 2.1. Bashkësitë fetare, në ushtrimin e aktivitetit ekonomik për vetëqëndrueshmëri financiare; dhe
 - 2.2. Organizatat jo qeveritare të angazhuara në aktivitet ekonomik me qëllim të mbështetjes së aktivitetit të saj jofitimprurës.
 - 2.3. Përfshihen nga pika 2.2 organizatat joqeveritare të cilat japin kredi me kamata fitimprurëse (institucionet mikrofinanciare).

KAPITULLI VII TAKSA KOMUNALE MBI MJETET MOTORIKE

Neni 24

Lartësia dhe pagesa e taksës komunale mbi mjetet motorike

1. Çdo person fizik i cili është banor i Komunës dhe pronëson mjet motorik dhe çdo person juridik që ka seli në Komunë dhe ka në pronësi mjet motorik, paguan taksën vjetore mbi pronësinë e mjetit motorik, si në vijim:

1.2.	Mjete motorike me 2 deri në 4 rrota deri në 50 cmm	10 €
1.3.	Automobil për udhëtarë deri në 3 ton	10 €
1.4.	Automobil për udhëtarë mbi 3 ton	20 €
1.5.	Kamionët deri në 3.5 ton	10 €
1.6.	Kamionët mbi në 3.5 ton	20 €
1.7.	Kombibusë dhe autobusë për transportim të udhëtarëve deri në 30 ulëse	10 €
1.8.	Autobusë për transportim të udhëtarëve mbi 30 ulëse	35 €

2. Personat e përcaktuar në paragrafin një (1) të këtij neni, taksën e paguajnë para regjistrimit të mjetit motorik sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 25
Lirimet nga taksa komunale mbi mjetet motorike

1. Nga pagesa e takës komunale mbi mjetet motorike janë të liruara mjetet motorike në pronësi të:

- 1.1. Institucioneve publike të Republikës së Kosovës;
- 1.2. Institucioneve ndërkombëtare dhe përfaqësitë diplomatike, përfshirë edhe stafin e huaj;
- 1.3. Kryqit të Kuq të Kosovës;
- 1.4. Emergjencës (makinat e zjarrfikësve, të ndihmës së shpejtë, si dhe makinat e komunitetit fetar për shërbesa fetare),
- 1.5. Të invalidëve të punës, civilë dhe ushtarakë.
2. Provë për këtë është leja e qarkullimit të automjetit apo dokumenti tjetër që dëshmon pronësinë.

Neni 26

Koha e ripërtëritjes së ngarkesave dhe taksave

1. Të gjitha ngarkesat dhe taksat për ushtrimin e veprimtarive komerciale, profesionale, duhet të ripërtërihen për çdo vit deri më 31 janar.
2. Lejet e automjeteve nëse janë në kompetencë të komunës ripërtërihen me rastin e regjistrimit, sipas ligjit përkatës pozitiv dhe urdhëresave përkatëse të ministrisë së linjës kompetente.
3. Afati i pagesës së taksave komunale caktohet 1(një) vit me të drejtë të ripërtëritjes.
4. Data e marrjes së taksës sipas aktvendimit të Drejtorisë kompetente vlenë deri në përmbushje të afatit njëvjeçar.

KAPITULLI VII
DREJTORIA E KADASTRËS, PRONËSISË DHE GJEODEZISË

Neni 27

Taksat në Drejtorinë e Kadastrës, Pronësisë dhe Gjeodezisë

1. Në Drejtorinë për Kadastër, Pronësi dhe Gjeodezi aplikohen këto taksa dhe tarifa:
2. Tarifat për dhënien e informatave nga Sistemi i Informacioneve Kadastrale të Tokave të Kosovës nga ZKK- të janë:

	PËRSHKRIMI	VLERA E TAKSËS NË EURO

2.1.	Vërtetim që personi fizik ose juridik nuk posedon prona -	3 €
2.2.	Certifikata e pronësisë (deri në dhjetë faqe shënime të shtypura) -	4 €
2.3.	Certifikata e pronësisë (mbi dhjetë faqe shënime të shtypura) -	20 €
2.4.	Kopja e planit -	4 €
2.5.	Kopje në formatin A3 me ortofoto (bardhë e zi) -	4 €
2.6.	Kopje në formatin A3 me ortofoto (kolor) -	5 €
2.7.	Historiati për një njësi kadastrale -	20 €
2.8.	Regjistrimi i kateve të lokaleve dhe të ndërtesave si njësi e veçantë -	20 € për njësi

3. Tarifat për bazën gjeodezike

PIKA	PËRSHKRIMI	VLERA E TAKSËS NË EURO
1	Pikat trigonometrike : Koordinatat Y, X, H, me përshkrim -	5 €
2	Pikat lidhëse: Koordinatat Y, X, H, me përshkrim -	4 €
3	Pikat poligonale: Koordinatat Y, X, H, me përshkrim -	3 €
4	Pikat e nivelimit:	

	Koordinatat Y, X, H, me përshkrim -	5 €
5	Pikat në linjë: Koordinatat Y, X, H -	2 €
6	Pikat e detajit Y, X, -	1 €

4. Tarifat për të dhënat në formën digjitale

PIKA	PËRSHKRIMI	VLERA E TAKSËS NË EURO
1	Parcela në format digjital (shpfile, dëg, gml, ili) deri në 1 ha-sipas kërkesës së palës (pronarit, të autorizuarit, gjeodeti i licencuar apo kompania gjeodete e licencuar) -	10 € për njësi
2	Parcela në format digjital (shpfile, dëg, gml, ili) mbi 1 ha deri 2 ha- sipas kërkesës së palës (pronarit, të autorizuarit, gjeodeti i licencuar apo kompania gjeodete e licencuar) -	20 €
3	Parcela në format digjital (shpfile, dëg, gml, ili) mbi 2.01 ha deri 5 ha – sipas kërkesës së palës (pronarit, të autorizuarit, gjeodeti i licencuar apo kompania gjeodete e licencuar) -	40 €
4	Parcela në format digjital (shpfile, dëg, gml, ili) mbi 5 ha – (sipas kërkesës së palës, pronarit, të autorizuarit, gjeodeti i	

	licencuar apo kompania gjeodete e licencuar) -	60 €
5	CD- kompakt disku -	0.50 CENT

5. Tarifat e shërbimit për ndërrimin e kulturave të parcelave

PIKA	PËRSHKRIMI	VLERA E TAKSËS NË EURO
1	Përgatitja e raportit për ndërrimin e kulturës së një parcele pa matje gjeodezike -	10 €

6. Tarifat e shërbimit për ndarjen e parcelave

PIKA	PËRSHKRIMI	VLERA E TAKSËS NË EURO
1	Krijimi i një parcele të re nga procesi i ndarjes së parcelës me sipërfaqe deri në 0.50 ha -	80 € për njësi
2	Krijimi i një parcele të re nga procesi i ndarjes së parcelës me sipërfaqe mbi 0.50 ha deri 1 ha -	90 € për një njësi
3	Krijimi i një parcele të re nga procesi i ndarjes së parcelës me sipërfaqe mbi 1 ha deri 2.5 ha -	120 € për një njësi
4	Krijimi i një parcele të re nga procesi i ndarjes së parcelës me sipërfaqe mbi 2.5 ha deri 5 ha -	140 € për një njësi
5	Krijimi i një parcele të re nga procesi i ndarjes së parcelës me	

	sipërfaqe mbi 5 ha deri 10 ha -	170 € për një njësi
6	Krijimi i një parcele të re nga procesi i ndarjes së parcelës me sipërfaqe mbi 10 ha -	300 € për njësi
7	Krijimi i një parcele të re nga procesi i ndarjes së parcelës në zona urbane sipas planit urbanistik -	150 € për një njësi

7. Tarifat e shërbimit për bashkimin e parcelave

PIKA	PËRSHKRIMI	VLERA E TAKSËS NË EURO
1	Krijimi i një parcele të re nga procesi i bashkimit të dy parcelave -	80 €
2	Per çdo parcelë tjetër në kufi -	35 €
3	Krijimi i një parcele të re nga procesi i bashkimit të dy parcelave në zona urbane sipas planit urbanistik -	150 €
4	Për çdo parcelë tjetër në kufi -	70 € për një njësi

8. Tarifat e shërbimit për përcaktimin e kufijve të parcelave

PIKA	PËRSHKRIMI	VLERA E TAKSËS NË EURO
1	Për një parcelë me sipërfaqe deri ne 0.50 ha -	130 € për një njësi
2	Për një parcelë me sipërfaqe mbi 0.50 ha deri 1.00 ha -	180 € për një njësi
3	Për një parcelë me sipërfaqe mbi 1 ha deri 2.5 ha -	220 € për një njësi

		njësi
4	Për një parcelë me sipërfaqe mbi 2.5 ha deri 5 ha -	330 € për një njësi
5	Për çdo hektar tjetër -	100 €
6	Për një parcelë urbane sipas planit urbanistik -	300 €

9. Tarifat e shërbimit për ri-rregullimin e kufijeve

PIKA	PËRSHKRIMI	VALUTA E TAKSËS NË EURO
1	Për një parcelë me sipërfaqe deri 0.50 ha -	80 €
2	Për një parcelë me sipërfaqe mbi 0.50 ha – deri 1 ha -	100 €
3	Për çdo hektar tjetër mbi një hektar -	100 €

10. Tarifat për regjistrimin e pronësisë sipas vlerës së transaksionit janë:

PIKA	PËRSHKRIMI	VALUTA E TAKSËS NË EURO
1	Deri në dhjetëmijë (10.000) euro është -	30 €
2	Prej dhjetëmijë e një (10.001) euro deri në pesëdhjetë (50.000) euro është -	50 €
3	Prej pesëdhjetëmijë e një (50.001) euro deri në njëqindmijë (100.000) euro është -	70 €
4	Prej njëqindmijë e një (100.001) euro deri në dyqindmijë (200.000) euro është -	90 €

5	Prej dyqindmijë e një (200.001) euro deri në pesëqindmijë (500.000) euro është -	120 €
6	Prej pesëqindmijë e një (500.001) euro deri në një milion (1 .000.000) euro është -	240 €
7	Mbi vlerën e një milion (1.000.000) euro, tarifa është -	500 €
8	Për vlerën e kontratës - transaksionit që është vërtetuar para vitit 1999 tarifa është -	50 €

11. Tarifa e regjistrimit të pronësisë në bazë të kontratës mbi dhuratën

PIKA	PËRSHKRIMI	VALUTA E TAKSËS NË EURO
1	Tarifa për regjistrimin e pronësisë sipas kontratës së dhurimit për anëtarin e familjes është -	30 €
2	Tarifa për regjistrimin e pronësisë sipas kontratës së dhurimit për personin që nuk është anëtar i familjes dhe nuk është e caktuar vlera pronës tarifa është -	80 €

12. Tarifa e regjistrimit të pronësisë, në bazë të kontratës mbi mbajtjen e përhjetshme

PIKA	PËRSHKRIMI	VALUTA E TAKSËS NË EURO
1	Tarifa për regjistrimin e pronësisë sipas kontratës së mbajtjes së përhjetshme për personin që është anëtar i familjes është -	30 € për çdo pronar
2	Tarifa për regjistrimin e pronësisë sipas kontratës së mbajtjes së përhjetshme për personin që nuk është anëtar i familjes dhe nuk është e caktuar vlera pronës tarifa është -	80 €

13. Tarifa e regjistrimit të pronësisë apo të drejtave tjera sendore në bazë të titullit juridik të organeve administrative dhe gjyqësore

PIKA	PËRSHKRIMI	VALUTA E TAKSËS NË EURO
1	Tarifa për regjistrimin e të drejtës së pronësisë mbi pronën e paluajtshme apo të drejtave tjera sendore në bazë të vendimit të organit administrativ apo gjyqësor është -	30 € për çdo pronar

14. Tarifa për regjistrimin e bashkëpronësisë apo pronësisë së përbashkët

PIKA	PËRSHKRIMI	VALUTA E TAKSËS NË EURO
1	Tarifa për regjistrimin e të drejtës në bashkëpronësi apo pronësi të përbashkët për bashkëpronarin apo pronarin e përbashkët është -	30 €
2	Tarifa për regjistrimin e të drejtës në pronësi të përbashkët për bashkëshortët është -	30 € për një titull juridik
3	Tarifa për regjistrimin e njësisë kadastrale si pjesë e ndërtesës është -	25 € për njësi

14.1. Lirohet nga tarifa për regjistrimin e pronësisë së përbashkët të ndërtesave kolektive në bashkëpronësi.

14.2. Lirohet nga tarifa për regjistrimin e hapësirave të përbashkëta si njësi të veçanta.

15. Tarifa e regjistrimit të ndarjes së bashkëpronësisë apo pronësisë së përbashkët

PIKA	PËRSHKRIMI	VLERA E TAKSËS NË EURO
1	Tarifa për regjistrimin e pronësisë në bazë të ndarjes nga bashkëpronësia apo pronësia e përbashkët për secilin bashkëpronar që bëhet pronarë individual është -	30 €

16. Tarifa e regjistrimit të pronësisë në bazë të trashëgimisë dhe të shkëputjes së bashkësisë familjare

PIKA	PËRSHKRIMI	VLERA E TAKSËS NË EURO
1	Tarifa për çdo trashëgimtar për regjistrimin e pronësisë në bazë të trashëgimisë është -	10 €
2	Tarifa për çdo trashëgimtar për regjistrimin e pronësisë në bazë të trashëgimisë, e cila rrjedh nga testamenti është -	20 €
3	Tarifa për regjistrimin e pronësisë në bazë të shkëputjes së bashkësisë familjare për çdo anëtar të familjes që bëhet pronar është -	20 €

17. Tarifat e regjistrimit të pronësisë në bazë të ndërrimit/këmbimit të pronës së paluajtshme

PIKA	PËRSHKRIMI	VLERA E TAKSËS NË EURO
1	Tarifa për regjistrimin e pronësisë në bazë të ndërrimit-këmbimit të pronës së paluajtshme për secilin pronar është -	40 €

18. Tarifa për regjistrimin e të drejtës së shfrytëzimit — qirambajtja

PIKA	PËRSHKRIMI	VLERA E TAKSËS NË EURO
1	Tarifa për regjistrimin e të drejtës së shfrytëzimit qirambajtjes për çdo njësi kadastrale, kur pronar është Qeveria apo Komuna, me kohëzgjatje deri në 10 vite është -	10 €
2	Tarifa për regjistrimin e të drejtës së shfrytëzimit — qirambajtjes për çdo njësi kadastrale, kur pronar është Qeveria apo Komuna, me kohëzgjatje prej dhjetë (10) vite deri në katërdhjetë (40) vite është -	30 €
3	Tarifa për regjistrimin e të drejtës së shfrytëzimit-qirambajtjes për çdo njësi kadastrale, kur pronar është Qeveria apo Komuna, me kohëzgjatje prej katërdhjetë (40) vite deri në nëntëdhjetë e nëntë (99) vite është -	50 €
4	Tarifa për regjistrimin e qirasë nga personi fizik apo juridik në kohëzgjatje deri në dhjetë (10) vite për çdo njësi kadastrale është -	10 €
5	Tarifa për regjistrimin e qirasë nga personi <u>fizik apo juridik</u> në kohëzgjatje <u>mbi dhjetë</u> (10) vite për çdo njësi kadastrale është -	20 €

--	--	--

19. Tarifat për regjistrimin e hipotekës sipas vlerës së kredisë të përcaktuar me dokumentin e hipotekës është:

PIKA	PËRSHKRIMI	VLERA E TAKSËS NË EURO
1	Deri në tridhjetëmijë (30.000) euro është -	20 €
2	Prej tridhjetëmijë e një (30.001) euro deri në pesëdhjetëmijë (50.000) euro është -	30 €
3	Prej pesëdhjetëmijë e një (50.001) euro deri në njëqindmijë (100.000) euro është -	60 €
4	Prej njëqindmijë e një (100.001) euro deri në dyqindmijë (200.000) euro është -	90 €
5	Prej dyqindmijë e një (200.001) euro deri në pesëqindmijë (500.000) euro është -	120 €
6	Prej pesëqindmijë e një (500.001) euro deri në një milion (1.000.000) euro është -	240 €
7	Mbi vlerën e një milion (1.000.000) euro, tarifa është -	400 €

20. Tarifat për modifikimin dhe fshirjen e hipotekës

PIKA	PËRSHKRIMI	VLERA E TAKSËS NË EURO
1	Tarifa për modifikimin e hipotekës së regjistruar është	10 €

21. Tarifa për regjistrimin, modifikimin dhe fshirjen e servitutit

PIKA	PËRSHKRIMI	VLERA E TAKSËS NË EURO
1	Tarifa për regjistrimin e të drejtës së servitutit për secilën parcelë dominante apo person është -	30 €
2	Tarifa për modifikimin e servitutit është -	10 €
3	Tarifa për fshirjen e servitutit nga Regjistri është -	20 €

22. Tarifa për regjistrimin, modifikimin dhe fshirjen e barrave dhe ngarkesave tjera

PIKA	PËRSHKRIMI	VLERA E TAKSES NË EURO
1	Tarifa për regjistrimin e barrës në tatimin në pronën e paluajtshme është -	20 €
2	Tarifa për regjistrimin e vërejtjes sipas Ligjit për Regjistrin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshme është -	40 €
3	Tarifa për regjistrimin e ndalesës nga Përbuaruesi Privat apo Gjykata në procedurë përmbarimore për secilën njësi kadastrale është	30 €

	-	
5	Tarifa për regjistrimin e vërejtjes të mbajtësit në pronën e paluajtshme të të mbajturit në momentin e lidhjes së Kontratës mbi mbajtjen e përhjetshme është -	20 €
6	Tarifa për modifikimin e barrës apo ngarkesës tjetër është -	10 €

22.1. Lirohet nga tarifa regjistrimi i masës së sigurisë (masës së përkohshme) apo modifikimin e saj.

22.2. Lirohet nga tarifa fshirja e barrës apo ngarkesës tjetër.

23. Tarifa për korrigjimin e të dhënave kadastrale

PIKA	PËRSHKRIMI	VLERA E TAKSËS NË EURO
1	Tarifa për korrigjimin e të dhënave kadastrale që konstatohet se janë regjistruar gabim si pasojë e dokumentacionit të dorëzuar nga palët është -	30 €

23.1. Lirohet nga tarifa për korrigjimin e të dhënave kadastrale që konstatohet se janë regjistruar si pasojë e gabimit të ZKK apo AKK, si dhe të gjitha gabimet e konstatuara nga sistemet e mëparshme.

23.2. Lirohet nga tarifa për korrigjimin e numrit identifikues "KCID" në numrin personal të pronarëve. ZKK është e obliguar që të bëjë korrigjimin e numrit identifikues "KCID" sipas detyrës zyrtare.

KAPITULLI VIII DREJTORIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

Neni 28

Taksat komunale nga lëmi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit

1. Për shfrytëzimin e objekteve të sportit paguhen taksat tarifore dhe atë siç vijon:

1.1.	Për shfrytëzimin e sallës sportive për aktivitete politike caktohet taksa tarifore për një orë	100
1.2.	Hapësira e parkingut te Palestra Sportive që shfrytëzohet nga autoshkollat për praktikë me kandidatë, pagesë vjetore	150
1.3.	Shfrytëzimi i fushës së futbollit “18 Qershori” nga klubet sportive (shkollat private) që aktivitetet e tyre i ushtrojnë në Komunën e Klinës por kanë të hyra direkte, pagesë mujore	20
1.4.	Shfrytëzimi i fushës së futbollit “18 Qershori” dhe fushën ndihmëse nga klubet sportive (që nuk janë të Komunës së Klinës por për shkaqe të ndryshme janë të interesuar ta shfrytëzojnë stadiumin) pagesë për një ndeshje	15
1.5.	Organizimet e turneve sportive që nuk janë organizime të komunës – Tarifa ditore	15
	Klubet sportive publike që janë të regjistruara si të tilla në federatë lirohen nga pagesa	

2. Për shfrytëzimin e objekteve të kulturës, Bibliotekës komunale publike, si dhe anëtarësimin përkatës caktohen taksat tarifore vjetore, siç vijojnë:

2.1.	Anëtarësimi i nxënësve të shkollave fillore caktohet taksa tarifore vjetore	1.50
2.2.	Anëtarësimi i nxënësve të shkollave të mesme caktohet taksa tarifore vjetore	2
2.3.	Anëtarësimi për studentë caktohet taksa tarifore vjetore	3
2.4.	Anëtarësimi për qytetarë caktohet taksa tarifore vjetore	6

3. Për shfrytëzimin e objektit të Qendrës së Kulturës “Jehona e Dukagjinit” caktohen tarifat dhe taksat si në vijim:

3.1.	Për tubime politike	100
